



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 11 regjistër (JR)
Datë 17.02.2022

Nr. 18 vendimi
Datë 06.03.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 06.03.2025, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Jerina Gjika, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 11/2022 (JR), datë 17.02.2022, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Binas Nina, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 489, datë 16.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Binas Nina.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në shkaqet e ankimit, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 489, datë 16.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Binas Nina (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i është nënshtruar procesit të vlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

3.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dërgoi në Komision raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konstatuar se:

- i. deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
- ii. ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;
- iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. nuk ka kryer deklarim të rremë; dhe
- v. subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2. DSIK-ja, pasi kreu procedurën për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, ka dërguar raportin² e arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin

¹ Raporti i ILDKPKI-së është përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 01.02.2019, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Binas Nina, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”.

² Raporti nr. {***} prot., datë 11.02.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 18.03.2021, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

39 të ligjit nr. 84/2016, ku konfirmon konstatimin fillestar për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Binas Nina.

3.3. KLP-ja³, pasi kreu vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet kontrollit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Binas Nina, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 489, datë 16.12.2021, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Binas Nina, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan [...].*
6. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

- Në lidhje me kriterin e pasurisë, arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara; (ii) ka kryer deklaramë të pamjaftueshme, që klasifikohen në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur në nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe të deklaramit të pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

- Në lidhje me kontrollin e figurës, nuk janë konstatuar elemente bindëse që të provonin ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme dhe, nisur edhe nga deklarimi i saktë i subjektit të rivlerësimit në deklaramtën për kontrollin e figurës, trupi gjykues çmon se, në këtë rast, nuk gjen zbatim pika 2 e nenit 61.

- Në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, për sa më sipër, trupi gjykues çmon se z. Binas Nina ka arritur një nivel kualifikues, sipas germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

- Gjithashtu, trupi gjykues çmon se disa nga problematikat e konstatuara në kriteret e vlerësimit të lartpërshkruara, të cilat, ndonëse nuk mjaftonin në vetvete për aplikimin e ndonjë mase specifike lidhur me kriterin në të cilin janë evidentuar – parë në tërësinë e tyre, krijojnë

³ Raporti nr. {***}, datë 16.02.2021, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për “Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Binas Nina” për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”.

bindjen se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe, rrjedhimisht, duhet të aplikohet edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

7. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit të Komisionit nr. 489, datë 16.12.2021, duke e kundërshtuar atë si një vendim i marrë në zbatim të gabuar të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
8. Subjekti i rivlerësimit e shoqëroi ankimin e tij me disa akte shkresore⁴ dhe, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar nga Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - i. *Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 489 vendimi, datë 16.12.2021.*
 - ii. *Shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave dhe bërjen e një analize të re financiare.*
 - iii. *Ndryshimin e vendimit nr. 489, datë 16.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Binas Nina, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.*

IV. Shqyrtimi i ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Binas Nina, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

⁴ (i) Deklaratë e avokatit N. D. nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 20.01.2022; (ii) raport teknik ekspertimi i vitit 2007, i ekspertit F. S..

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vlerëson se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 489, datë 16.12.2021, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
12. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja bashkëlidhur ankimit, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë marrjen e provave të reja, përveçse kur provon se, pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në analizën e mësipërme, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se aktet e dorëzuara së bashku me ankimin, nuk përmbushin kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces dhe, për rrjedhojë, kërkesa e subjektit nuk u pranua.
13. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet dokumentacionit të fashikullit, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe vlerësimi i trupit gjykues

14. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale, subjekti i rivlerësimit i ka bazuar në pretendimet e mëposhtme.
 - 14.1. Vendimi i Komisionit është i pabazuar në prova dhe masa disiplinore e shkarkimit nga detyra është vendosur në kundërshtim me nenin D, pika 5, dhe nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, pasi ndaj subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar pasuri të fshehura apo kontakte të papërshtatshme që të justifikonin zbatimin e kësaj mase.
 - 14.2. Vlerësimi i kriterit të pasurisë është kryer në kundërshtim me ligjin dhe standardet e vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Komisioni ka cenuar të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së, pasi çështja nuk është shqyrtuar nga një organ i pavarur dhe i paanshëm dhe vendimi ka qenë i paragjykuar dhe i paracaktuar. Në këtë kuadër, ankuesi pretendon se zhvillimi i seancës dëgjimore të datës 06.12.2021, në mungesën e tij, si dhe publikimi i rezultateve të hetimit dhe

i qëndrimit të Komisionit në media përpara dëgjimit të tij, dëshmojnë për një vendimmarrje të paracaktuar, ndërsa seanca dëgjimore e datës 15.12.2021, ka qenë thjesht formale dhe e organizuar për të mbuluar shkeljet procedurale të kryera më parë.

14.3. Kufizimet e të drejtave të parashikuara në kuadër të ndryshimeve kushtetuese për procesin e rivlerësimit, duhet të respektojnë kriteret e nenit 17 të Kushtetutës dhe nuk mund të tejkalojnë standardet minimale të mbrojtjes të garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

14.4. Kalimi i barrës së provës është kryer vetëm formalisht dhe disa prej konkluzioneve të Komisionit nuk janë bërë objekt debati gjatë seancës dëgjimore, çka tregon se vendimi përfundimtar është formësuar që në fazën e raportit paraprak të rezultateve të hetimit.

14.5. Komisioni, në kundërshtim me nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ka refuzuar marrjen e provës me dëshmitarë të kërkuar prej subjektit të rivlerësimit, duke i konsideruar këto prova të panevojshme.

14.6. Provat e administruara kryesisht nga Komisioni, si dhe ato të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në kuadër të barrës së provës, sipas këtij të fundit, rrëzojnë konstatimet e Komisionit të pasqyruara në raportin përfundimtar të rezultateve të hetimit.

15. Në përgjigje të këtyre pretendimeve, trupi gjykues vëren se ato janë formuluar në terma të përgjithshëm dhe nuk shoqërohen me argumente konkrete apo rrethana specifike që të evidentojnë mënyrën se si Komisioni ka vepruar në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore të referuara në ankim.
16. Subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se Komisioni e ka paragjykuar çështjen, pasi ka përfunduar hetimin administrativ dhe ka vendosur kalimin e saj në seancë dëgjimore pa marrë në konsideratë provat e paraqitura prej tij. Në mënyrë të veçantë, ai pretendon se Komisioni nuk ka kryer një analizë të re financiare në funksion të vlerësimit të raportit të auditimit kontabël të depozituar prej tij dhe nuk ka reflektuar gjetjet dhe konkluzionet e këtij raporti në rezultatet e hetimit administrativ. Sipas subjektit të rivlerësimit, këto rrethana tregojnë se Komisioni kishte krijuar paraprakisht bindjen e tij mbi çështjen dhe se hetimi administrativ nuk është zhvilluar në mënyrë të plotë dhe objektive.
17. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues vlerëson se, nga analiza e vendimit të Komisionit, rezulton se, për secilën pasuri të verifikuar, në rubrikën “Hetimi i kryer nga Komisioni”, janë pasqyruar veprimet konkrete hetimore të ndërmarra, aktet e administruara, burimet e informacionit dhe vlera provuese e tyre. Këto të dhëna janë bërë objekt i një analize ligjore dhe financiare, mbi bazën e së cilës Komisioni ka arritur në konkluzionet përkatëse për secilin prej konstatimeve të tij.
18. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka vlerësuar analizën financiare të përgatitur nga audituesi ligjor i përzgjedhur prej tij, trupi gjykues konstaton se, megjithëse Komisioni nuk ka paraqitur një qëndrim të posaçëm dhe të veçuar për secilin element të kësaj analize, nga përmbajtja e arsytimit të vendimit, rezulton se ajo është marrë në konsideratë dhe është shqyrtuar në kuadër të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, së bashku me provat dhe shpjegimet e tjera të administruara gjatë procesit. Vetëm fakti që

Komisioni nuk ka ndarë të njëjtin vlerësim me audituesin e zgjedhur nga subjekti, nuk nënkupton se analiza e paraqitur prej tij është shpërfillur apo nuk është marrë në shqyrtim. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

19. Lidhur me pretendimin e subjektit se në procedurën e rivlerësimit, si dhe në vendimin e ankimuar, evidentohen elemente të theksuara paragjykimi dhe një vendimmarrje e paracaktuar, çka, sipas tij, vë seriozisht në dyshim nëse është gjykuar nga një organ i pavarur dhe i paanshëm, trupi gjykues vëren se këto pretendime mbështeten në argumentin se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë, si dhe nuk ka reflektuar në vendim provat, argumentet dhe shpjegimet e paraqitura prej tij në kuadër të ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes dhe të barrës së provës.
20. Në vlerësim të trupit gjykues, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mosreflektimin e shpjegimeve të tij lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, apo për mosparaqitjen e tyre nga relatori gjatë seancës dëgjimore publike, si dhe pretendimi për mungesë arsyetimi apo vlerësimi të provave në rezultatet e hetimit, nuk përbëjnë *apriori* cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor.
21. Në këtë drejtim, konstatohet se Komisioni ka trajtuar në vendimin e tij shpjegimet dhe pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si ato të depozituara në formë të shkruar, ashtu edhe ato të parashtruara verbalisht gjatë seancës dëgjimore. Këto qëndrime janë pasqyruar në një rubrikë të veçantë të vendimit, me titull “Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit”, çka dëshmon se ato kanë qenë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga ana e Komisionit.
22. E drejta për t’u dëgjuar dhe për të paraqitur kundërshtime sipas parimit të kontradiktoritetit nënkupton mundësinë efektive të subjektit për të parashtruar qëndrimin e tij dhe për t’u mbrojtur, por jo detyrimin e organit vendimmarrës për të pranuar apo për të ndjekur argumentet e paraqitura prej tij. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit vlerësohet i pabazuar.
23. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se shpallja e vendimit nga Komisioni është bërë pa kaluar as 24 orë nga përfundimi i seancës dëgjimore, çka, sipas tij, nuk ka lënë kohën e nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimeve të parashtruara prej tij gjatë seancës dëgjimore dhe në kuadër të barrës së provës.
24. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues vlerëson se mënyra e administrimit të seancës dëgjimore nga Komisioni, ka qenë në përputhje me parashikimet e nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore”. Nga interpretimi i kësaj dispozite, rezulton se shpallja e vendimit mund të bëhet si në vijim të drejtpërdrejtë të seancës dëgjimore, ashtu edhe pas tërheqjes së trupit gjykues për marrjen e vendimit, duke u njoftuar më pas data dhe ora e shpalljes së tij.
25. Në këtë kuadër, koha që i nevojitet trupit gjykues për t’u tërhequr dhe për të marrë vendimin, nuk është objekt rregullimi të posaçëm ligjor dhe nuk kushtëzohet nga ndonjë afat minimal i përcaktuar në ligj. Për rrjedhojë, fakti që vendimi është shpallur brenda një kohe të shkurtër pas zhvillimit të seancës dëgjimore, nuk përbën, në vetvete, tregues të cenimit të procesit të rregullt ligjor.

26. Trupi gjykues vlerëson se i rëndësishëm për respektimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor, është garantimi efektiv i të drejtave procedurale të subjektit gjatë procedurës së rivlerësimit, përfshirë të drejtën për t'u njohur me rezultatet e hetimit, për të paraqitur prova dhe shpjegime, si dhe për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore publike. Në rastin konkret, këto të drejta janë garantuar dhe ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, ndaj pretendimi se koha ndërmjet zhvillimit të seancës dëgjimore dhe shpalljes së vendimit cenon ligjshmërinë e procesit apo vë në dyshim vendimmarrjen e Komisionit, vlerësohet i pabazuar.
27. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni ka zhvilluar një proces të njëanshëm dhe ka marrë një vendim të paracaktuar. Në mbështetje të këtij pretendimi, ai parashtron se më datë 06.12.2021, Komisioni zhvilloi seancën dëgjimore në mungesë të tij, ndonëse ai kishte paraqitur dokumentacion mjekësor që provonte pamundësinë objektive për të qenë i pranishëm në seancë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.
28. Sipas subjektit të rivlerësimit, pavarësisht mungesës së tij dhe pa dëgjuar shpjegimet që ai do të paraqiste në seancë, Komisioni bëri publike rezultatet e hetimit administrativ dhe qëndrimin e tij lidhur me çështjen, duke i shpërndarë ato në media. Sipas tij, kjo sjellje përbën shkelje të ligjit dhe përforcon dyshimet mbi paanshmërinë e Komisionit dhe karakterin e paracaktuar të vendimmarrjes.
29. Nga aktet e fashikullit të çështjes, rezulton se trupi gjykues i Komisionit, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret e vlerësimit, më datë 21.10.2021, vendosi: *(i) përfundimin e hetimit administrativ për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Binas Nina; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe mbi të drejtën për t'u njohur me materialet e dosjes, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.*
30. Më datë 25.10.2021, subjektit të rivlerësimit iu komunikuan rezultatet e hetimit administrativ dhe analiza financiare e kryer nga Komisioni, si dhe u njoftua për të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime apo për të kërkuar depozitim dhe provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht. Subjekti i rivlerësimit e ushtroi të drejtën për t'u njohur me aktet e dosjes, duke marrë kopje të dokumenteve në format elektronik.
31. Me e-mail-in e datës 01.11.2021, subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrjen e afatit për paraqitjen e përgjigjeve të tij, të përcaktuar nga Komisioni për në datën 08.11.2021, kërkesë e cila u pranua nga Komisioni, duke zgjatur me një javë afatin për dhënien e shpjegimeve dhe paraqitjen e dokumentacionit mbështetës.
32. Më datë 16.11.2021, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike, kërkoi thirrjen për dëgjues të 10 dëshmitarëve, duke parashtruar emrat dhe gjeneralitetet e tyre, kërkesë e cila u refuzua nga Komisioni, i cili, me vendimin nr. {***}, datë 16.11.2021, vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për thirrjen e dëshmitarëve, në bazë të pikës 1 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, me arsyetimin se, duke mbajtur në konsideratë faktet, rrethanat dhe dokumentacionin e disponuar, të gjithë personat e listuar nga subjekti si dëshmitarë, kishin kryer më herët deklaratime para noterit; deklaratatë të cilat ishin paraqitur prej tij dhe ishin pjesë e dosjes së administruar nga Komisioni, ndaj do të shqyrtoheshin dhe vlerësoheshin lidhur me rrethanat përkatëse.

33. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. {***}, datë 17.11.2021, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Binas Nina në seancën dëgjimore të caktuar më datë 22.11.2021, ora 10:00. Në këtë datë, subjekti i rivlerësimit vuri në dispozicion të Komisionit një raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë për shkak të COVID-SARS. Bazuar në këtë raport mjekësor, Komisioni caktoi një datë tjetër për zhvillimin e seancës dëgjimore, konkretisht, datën 06.12.2021, ora 9:30.
34. Në këtë datë, subjekti i rivlerësimit dërgoi nëpërmjet postës elektronike një kërkesë të re për shtyrjen e seancës, me arsyetimin se ishte në pamundësi për t'u paraqitur. Kësaj kërkesë subjekti i kishte bashkëlidhur një tjetër raport mjekësor, sipas të cilit rezultonte me paaftësi të përkohshme në punë deri më datë 12.12.2021. Në padijeni të këtij njoftimi, Komisioni zhvilloi seancën dëgjimore, në të cilën u bënë me dije publikisht gjetjet e rezultateve të hetimit administrativ, por nuk u shpall vendimi lidhur me subjektin e rivlerësimit.
35. Në këto rrethana dhe në vijim të komunikimit me *e-mail* të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, në respektim të procesit të rregullt ligjor dhe me qëllim garantimin e së drejtës së subjektit për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në seancë dëgjimore, e njoftoi atë nëpërmjet postës elektronike për vendimin nr. {***}, datë 07.12.2021, me të cilin trupi gjykues, me shumicë votash, vendosi caktimin e një seance tjetër dëgjimore, e cila u zhvillua më datë 15.12.2021, ora 12:30, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar dhe të subjektit të rivlerësimit.
36. Komunikimet elektronike ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit tregojnë se subjekti është pyetur, i është dhënë e drejta të njihet me aktet, ka dhënë shpjegime, ka përcjellë dokumente në cilësinë e provës, i është dhënë kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe është ftuar për t'u dëgjuar në seancë, ku ka marrë pjesë, ka parashtruar qëndrimin e tij mbi gjetjet e Komisionit dhe ka diskutuar para anëtarëve të trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar.
37. Po kështu, duke iu referuar procesverbalit të seancës dëgjimore, nuk rezulton që ky i fundit të ketë parashtruar pretendime për shkelje të të drejtave të garantuara nga ligji gjatë procesit të zhvilluar ndaj tij në Komision, apo të ketë paraqitur kërkesa specifike për njëanshmëri apo mosrespektim të parimeve të procesit të rregullt ligjor.
38. Në vlerësim të sa më sipër, as procesi i hetimit administrativ dhe as seanca dëgjimore nuk mund të vlerësohen si të zhvilluara në shkelje të ligjit, formale, të paracaktuara apo të paragjykuara, për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka pasur të drejtën dhe mundësinë të kundërshtojë çdo gjetje të Komisionit, si dhe të shpjegojë të gjitha faktet dhe provat e mbledhura në kuadër të kalimit të barrës së provës, në interes të mbrojtjes së tij, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në seancë dëgjimore.
39. Fakti që Komisioni ka bërë një vlerësim të ndryshëm të provave nga ai i pretenduar prej subjektit të rivlerësimit, nuk cenon rregullsinë apo plotësinë e hetimit administrativ dhe as nuk përbën dëshmi për vendimmarrje të paracaktuar apo të paragjykuar. Përkundrazi, ai përbën shprehje të tagrave të institucioneve të rivlerësimit për të vlerësuar, sipas bindjes së tyre të brendshme dhe në përputhje me logjikën juridike, provat e paraqitura, në harmoni dhe në krahasim me të gjitha të dhënat e tjera të rezultuara nga hetimi. Në këto kushte, pretendimet e subjektit të rivlerësimit vlerësohen të pabazuara.

40. Në vlerësim të pretendimit sa u takon parashikimeve për kufizimin e të drejtave kushtetuese në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, trupi gjykues çmon se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve u konceptua dhe u miratua si një mekanizëm i jashtëzakonshëm kushtetues, me qëllim rivendosjen e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë nëpërmjet verifikimit të integritetit, figurës dhe pasurisë së subjekteve të rivlerësimit. Për realizimin efektiv të këtij procesi, Kushtetuta ka parashikuar, në mënyrë të posaçme, kufizime të caktuara të të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, si dhe pasojat që rrjedhin nga mosplotësimi i standardeve kushtetuese dhe ligjore të rivlerësimit.
41. Kufizimet kushtetuese në funksion të procesit të rivlerësimit, janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si të pajtueshme me Kushtetutën dhe me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen *Xhoxhaj k. Shqipërisë*, ka konstatuar se procesi i rivlerësimit dhe masat e parashikuara në kuadër të tij ndjekin një interes publik legjitim dhe nuk cenojnë në mënyrë joproporcionale të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit.
42. Gjithashtu, subjektet e rivlerësimit kanë qenë në dijeni të kuadrit kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit, përfshirë përcaktimet e nenit A të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon kufizime të caktuara të të drejtave kushtetuese për nevojat e zhvillimit të këtij procesi. Këto kufizime burojnë drejtpërdrejt nga Kushtetuta dhe ligji dhe zbatohen njësoj për të gjitha subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.
43. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me cenimin e të drejtave të tij për shkak të kufizimit të të drejtave kushtetuese të parashikuara në kuadër të procesit të rivlerësimit, është i pambështetur.
44. Në shqyrtim të pretendimit se Komisioni në mënyrë të padrejtë, nuk i ka pranuar kërkesën për marrjen e provës për dëshmitarë, trupi gjykues vlerëson të drejtë vendimmarrjen e Komisionit për mospranimin e kërkesës për marrjen e provës me dëshmitarë, si dhe arsyetimin e dhënë në mbështetje të saj. Në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe duke marrë në konsideratë faktet, rrethanat e çështjes dhe dokumentacionin e administruar, rezulton se të gjithë personat e propozuar nga subjekti i rivlerësimit si dëshmitarë, kishin dhënë më parë deklarime noteriale lidhur me rrethanat për të cilat kërkohej dëgjimi i tyre.
45. Këto deklarata janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës dhe janë administruar në dosjen e rivlerësimit. Për rrjedhojë, Komisioni ka vlerësuar se thirrja dhe dëgjimi i këtyre personave nuk do të sillte elemente të reja me rëndësi për zgjidhjen e çështjes, për sa kohë që qëndrimet e tyre ishin tashmë të dokumentuara dhe pjesë e akteve të administruara. Në këto kushte, deklaratimet noteriale janë shqyrtuar dhe vlerësuar në raport me rrethanat përkatëse të hetimit administrativ, ndaj mospranimi i kërkesës për dëgjimin e tyre si dëshmitarë, nuk rezulton të ketë cenuar të drejtën e mbrojtjes së subjektit të rivlerësimit.

C. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimi i trupit gjykues

46. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim, vlerësimin e Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë se: *subjekti i rivlerësimit: (i) ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e*

deklaruar; (ii) ka kryer deklarime të pamjaftueshme, që klasifikohen në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur në nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe të deklarimit të pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

47. Kundërshtimin e tij, subjekti i rivlerësimit e ka bazuar në disa pretendime me natyrë të përgjithshme dhe në pretendime specifike për secilën prej pasurive të konstatuara me problematika nga Komisioni si më poshtë.
48. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi për kriterin e pasurisë është marrë në kundërshtim me parashikimet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenet 30, 32 dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe me vetë qëllimin e këtij ligji. Sipas subjektit, nga ballafaqimi i deklaratës *vetting* me deklaratimet periodike vjetore, rezulton se deklarimi i pasurisë ka qenë i saktë, se nuk ka pasur fshehje pasurie dhe se burimi i të ardhurave dhe i pasurive të krijuara ka qenë i ligjshëm. Subjekti pretendon se Komisioni ka dalë jashtë misionit dhe detyrës së tij, duke mos konsideruar si burim të ligjshëm të ardhurat që, sipas tij, provohen përtej çdo dyshimi, edhe nëpërmjet deklaratave noteriale të hartuara shumë vite përpara krijimit të konceptit të rivlerësimit kalimtar.
49. Subjekti pretendon gjithashtu se Komisioni nuk ka kuptuar drejt qëllimin dhe natyrën e posaçme të rregullimit të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka marrë në konsideratë rezultatet e raportit të ILDKPKI-së dhe të audituesit ligjor, duke kryer një vlerësim jo të drejtë të fakteve dhe provave të administruara. Sipas tij, referuar kontrollit logjik dhe aritmetik të deklarimeve periodike të pasurisë, analizës financiare të kryer nga ILDKPKI-ja, si dhe analizës financiare të audituesit ligjor mbi të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara ndër vite nga familja e subjektit të rivlerësimit, provohet burimi i ligjshëm i të ardhurave.
50. Subjekti pretendon se metodologjia e përdorur nga Komisioni për përlllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo deklaram periodik, krijon dyshime për mungesë paanshmërie, pasi analiza financiare është kryer në mënyrë të copëzuar, pa përfshirë të ardhurat, burimi i të cilave, sipas tij, provohet të jetë tërësisht i ligjshëm. Më tej, subjekti pretendon se Komisioni nuk ka arsyetuar në vendim përse analiza financiare nuk është kryer për të gjitha vitet e deklarimit, të lidhura me njëra-tjetrën, sikurse ka vepruar ILDKPKI-ja, me qëllim arritjen e një vendimmarrjeje sa më të drejtë lidhur me burimet e ligjshme të të ardhurave dhe pasurive. Sipas subjektit, kjo mënyrë veprimi krijon dyshimin se ndaj tij, është zbatuar një trajtim i ndryshëm, në shkelje të parimit të barazisë para ligjit.
51. Komisioni nuk ka administruar dokumentacionin shtesë të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk ka kryer një analizë të re financiare, me qëllim garantimin e trajtimit të barabartë të subjekteve të rivlerësimit, në përputhje me parimin e barazisë para ligjit.
 - *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 106 m², ndodhur në Elbasan:*
52. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit për këtë pasuri se: *subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, lidhur me momentet e kryerjes së pagesave të këstit të parë dhe të dytë, në shumën 2.250.000 lekë, të apartamentit në analizë. Për sa i përket analizës*

financiare të pagesave të këstit të parë dhe të dytë, brenda nëntorit të vitit 2000, duke mos e konsideruar të provuar arkëtimin e mëhershëm të pagesës së çmimit të shitjes së apartamentit ekzistues, edhe pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, rezultati mbetet sërish negativ, ndonëse vlera negative ulet në masën (-) 664.150 lekë, si pasojë e përfshirjes në analizë të dhurimeve të vëllait të subjektit të rivlerësimit, të provuara me dërgesat financiare nga ShBA-ja nëpërmjet Western Union dhe Bankës së Kursimeve. Sa i përket këstit të tretë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për ta kryer atë pagesë me burime të ligjshme financiare.

53. Komisioni e ka mbështetur vlerësimin e tij në konstatimet se: [...] për sa i përket pagesës së këstit të parë dhe këstit të dytë, subjekti i rivlerësimit, përveç deklaratës noteriale, nuk arriti të provojë me dokumentacion të kohës, pagesën e këstit të parë dhe këstit të dytë për të provuar sa ka pretenduar, se nuk janë paguar sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pagimin e shumës totale të pretenduar si të kryer deri në fund të vitit 2003, mbeten vetëm në nivel deklarativ dhe nuk mund të merren në konsideratë për të ndryshuar afatet e përlllogaritjeve të burimeve financiare përkatëse, për sa kohë ato nuk janë provuar me dokumentacion ligjor, si dhe as nuk ka rezultuar e deklaruar në deklaratën për vitin 2003 ndonjë shpenzim/investim i kryer përgjatë këtij viti për pasurinë në fjalë. Gjithashtu, lidhur me pretendimin për arkëtimin paraprak të një pjese të çmimit të shitjes së një apartamenti ekzistues dhe, konkretisht, rreth 6 muaj përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte vërtetësinë e këtij pretendimi, pasi nuk vuri në dispozicion ndonjë dokumentacion për të provuar kryerjen e pagesës më herët nga sa është përshkruar në aktin përkatës. Ndërkohë që deklarata noteriale e vitit 2021, nisur edhe nga jurisprudenca e konsoliduar tashmë mbi këto problematika, nuk mund ta ndryshojë përmbajtjen e aktit të shitjes, për sa kohë që nuk provohet e kundërta. Për më tepër që ky version nuk është deklaruar ndonjëherë më herët nga subjekti i rivlerësimit për sa i përket momentit të ndryshëm të kryerjes së pagesave hyrëse, nga shitja e pasurisë në fjalë. Për më tepër që ky version nuk është bërë ndonjëherë më herët nga subjekti, për sa i përket momentit të ndryshëm të kryerjes së pagesave hyrëse nga shitja e pasurisë në fjalë.
54. Kundërshtimin e tij për vlerësimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit e ka bazuar në pretendimet se:

54.1. Dokumentacioni provues në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e pagesave të këstit të parë dhe të këstit të dytë, është i plotë dhe ligjor, si dhe i është vënë në dispozicion Komisionit. Me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.04.2001, ka provuar se i ka shitur shtetas N. D. një apartament në vlerën 1.950.000 lekë. Në përmbajtje të kësaj kontrate, parashikohet se: *shitësi Binas Nina deklaroi që e ka marrë shumën 1.950.000 lekë jashtë zyrës noteriale dhe blerësja N. D. deklaroi të njëjtin fakt, që i ka dhënë paratë jashtë zyrës noteriale.* Këtë shumë blerësja e ka shlyer në dy pagesa, ku fillimisht është paguar shuma 1.500.000 lekë, në kohën që ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, ndërsa shuma prej 450.000 lekësh është paguar me vonë. Hartimi i akteve noteriale për shitblerjen e pasurive të paluajtshme në vitin 2001, nuk kërkonte depozitim të shumës së parave të blerjes apo shitjes nëpërmjet bankës apo ndonjë institucioni tjetër financiar. Fakti i kryerjes së pagesave provohet përtej çdo dyshimi të

arsyeshëm dhe nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 08.08.2021, e shtetases N. D..

54.2. Deklarimin për herë të parë të kësaj pasurie, e ka bërë në vitin 2003 dhe nuk ekziston asnjë deklarim i mëparshëm që provon të kundërtën e sa deklaruar prej tij, si dhe nuk ekziston asnjë e dhënë kundër sa ka shpjeguar për Komisionin, i cili duhej ta vlerësonte personin e tij si të besueshëm, pasi, nga ana e tij, janë paraqitur të gjitha provat e mundshme. Sa më lart, shuma prej 1.950.000 lekësh e marrë në kohën e lidhjes së kontratës me shoqërinë “{***}” ShPK, duhet vlerësuar si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit, për likuidimin e kështit të parë dhe të kështit të dytë.

54.3. Konstatimi i Komisionit se pagesat e kështit të parë dhe të kështit të dytë janë kryer në datat 18.10.2000 dhe 18.11.2000, sipas përcaktimeve në kontratën e sipërmarrjes, është i gabuar pasi provohet se kjo kontratë nuk është respektuar nga sipërmarrësi, i cili kolaudimin e objektit e ka kryer pas 10 vitesh.

54.4. Konkluzioni i Komisionit për mungesë burimesh financiare në vlerën (-) 1.662.740 lekë, është i pabazuar pasi në këtë analizë nuk është përlllogaritur shuma prej 1.950.000 lekësh dhe, po ashtu, Komisioni nuk ka përfshirë të ardhurat e përfituara në vitet 2001 dhe 2002 nga shtetasit B. S., I. B. dhe A. B., si dhe për të gjitha vitet Komisioni ka përlllogaritur shpenzime më të larta jetese se sa janë kryer realisht nga familja e tij.

55. Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton dhe vlerëson si vijon.

56. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament nr. {***}, kati i {***}, pallati {***}, lagjja “{***}”, Z.K {***}, Elbasan, sipërfaqja 106 m², vlera 4.300.000 lekë, pjesët takuese 50% me 50 %. Burimi i krijimit: Paguar në vitin 2003 shuma prej 4.000.000 lekësh, për sipërfaqen 100 m² sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.10.2000, lekët janë përfitur nga shitja e apartamentit, datë 18.04.2001, në shumën 1.950.000 lekë, apartamenti i shitur është blerë nga ana ime më datë 02.08.1995, me kontratën {***} rep, nr. {***} vol. akt., nga shitësit P. S. dhe M. S., për shumën 520.000 lekë. 1.900.000 lekë janë përfitur nga shitja e apartamentit më datë 31.10.2003, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., blerës shtetasja A. N., ky apartament është blerë nga ana ime më datë 08.05.2000, me numër kontrate nr. {***} rep., nr. {***} kol., shtetasit M. C.. Pjesa tjetër e shumës është nga të ardhurat e mia e kursimet në vitin 2003. Paguar në vitin 2012, për shtesë sipërfaqeje prej 6 metrash katrorë në shumën 300.00 lekë, lekët janë krijuar nga paga ime dhe e bashkëshortes.*

57. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2003, me sipërfaqe 100 m², me vlerë 4.000.000 lekë, dhe me burim krijimi përkatësisht: (i) 2.000.000 lekë të përfituara nga shitja e apartamentit më datë 18.4.2001⁵; (ii) 1.900.000 lekë të përfituara nga shitja e apartamentit më datë 31.10.2003⁶; dhe (iii) 100.000 lekë të ardhura nga paga.

⁵ Pasuria me nr. hipotekor {***} dhe numër rendor {***}, datë 4.8.1995.

⁶ Pasuria me nr. hipotekor {***}.

58. Në DIPP-në e vitit 2012, si dhe në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar pagesën prej 300.000 lekësh për sipërfaqen shtesë prej 6 m² në apartamentin e banimit të deklaruar në vitin 2003.
59. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni e ka ftuar subjektin që të paraqesë dokumentacionin për të provuar kohën e shlyerjes së kësteve. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: *pagesën kam filluar ta paguaj duke ia dhënë lekët në dorë shtetasit A. G., (jashtë sistemit bankar) që nga lidhja e kontratës së datës 18.10.2000, e kam vazhduar pagesën deri në fund të vitit 2003, unë i kam paguar atij shumën prej 4.000.000 (katër milionë) lekësh, këstet dhe kohën e pagesës nuk e mbaj mend dhe nuk kam mbajtur dokumentacion. Në vitin 2003, pallati ishte plotësisht i ndërtuar dhe unë banoja fizikisht me familjen, dhe shumën e paguar prej 4.000.000 (katër milionë) lekësh e kam deklaruar që në DIPP-në e vitit 2003 (Deklarimi fillestar). Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresë me nr. {***} prot., datë 9.8.2021, nga ASHK Elbasan, e cila ka vënë në dispozicion dokumentacionin në bazë të të cilit është kryer regjistrimi i pasurisë objekt shqyrtimi⁷.*
60. Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe ka verifikuar vërtetësinë e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me kohën e përfitimit dhe mënyrën e përdorimit të shumës prej 1.950.000 lekësh, të përfituar nga shitja e apartamentit ekzistues, të deklaruar prej tij si një nga burimet për krijimin e kësaj pasurie.
61. Referuar deklaramëve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se, deri në fund të vitit 2003, subjekti ka deklaruar si të paguar shumën prej 4.000.000 lekësh, pa përcaktuar këstet përkatëse dhe kohën e pagesës së tyre. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar se nuk i mban mend këto pagesa dhe se nuk ka ruajtur dokumentacion lidhur me to, ndërkohë që, në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament që prej vitit 2001⁸.
62. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, konstatoi se nuk rezultoi të ketë dokumentacion provues lidhur me kohën e shlyerjes së këstit të parë dhe të dytë, në kuadër të kontratës së sipërmarrjes së lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se analiza e burimit të krijimit të kësaj pasurie duhet të kryhet duke u mbështetur në përcaktimet e kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë

⁷ Nga dokumentacioni i paraqitur, ka rezultuar se fillimisht, me vendim të KRRT-së Elbasan nr. {***}, datë 12.7.2000, ishte miratuar leja e ndërtimit për objektin pallat 8 kate + bodrum për trashëgimtarët e z. I. Q., ndërtues “{***}” ShPK. Më pas, me vendimin e KRRT-së Elbasan nr. {***}, datë 5.4.2011, është miratuar saktësimi i planvendosjes dhe projektit, si dhe rikondicionimi i objektit “Pallat 8 kate” në “Godinë banimi kolektive 1 kat bodrum + 1 kat lokal + 7 kate banim + 1 kat me sipërfaqe të reduktuar”, me investitor z. A. G..

⁸ Referuar deklaramit të subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, rezultoi se ai ka deklaruar adresë banimi që prej vitit 2001, adresën e apartamentit objekt i kësaj analize. Ky informacion gjen mbështetje edhe sipas kontratës së shitjes së apartamentit ekzistues nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.04.2001, midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit N. D., ku, ndër të tjera, përcaktohet se apartamenti, i cili i ka shërbyer subjektit të rivlerësimit si banesë nga momenti i emërimit në detyrë deri në vitin 2001, pas shitjes ishte parashikuar të lirohej nga shitësi brenda datës 30.09.2001, kohë e cila korrespondon edhe me vitin kur ai ka deklaruar si adresë banimi vendndodhjen e apartamentit të blerë sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.10.2000.

18.10.2000, si akti i vetëm i kohës që përmban të dhëna dhe informacion mbi kohën dhe mënyrën e shlyerjes së kësteve për apartamentin objekt shqyrtimi.

63. Nga përmbajtja e kontratës së lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e porositësit, dhe shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit, rezulton se palët kanë rënë dakord për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 100 m², në katin e katërt të një godine shumëkatëshe në lagjen “{***}”, kundrejt çmimit prej 4.500.000 lekësh. Konkretisht, në nenin 2 të kontratës përcaktohet se porositësi: *[...] likuidon në dorë, jashtë kësaj zyre noteriale, shumën 1.500.000 lekë përkundrejt mandatarkëtimit.* Në nenin 3, parashikohet se porositësi: *[...] të derdhë për llogari të firmës ndërtuese edhe 750.000 lekë si paradhënie për fillimin e punimeve pas 30 ditëve, ndërsa në nenin 4 parashikohet se: 10 ditë pas njoftimit të përfundimit të karabinasë së godinës, porositësi detyrohet të derdhë paradhënien e dytë prej 40% të vlerës së apartamentit dhe pjesa tjetër e mbetur do të paguhet me dorëzimin përfundimtar të objektit (çelësat në dorë).*
64. Sa më sipër, ndonëse gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se pagesat nuk janë kryer sipas përcaktimeve të kontratës së sipërmarrjes, me argumentin se kjo kontratë nuk është zbatuar në mënyrë korrekte nga sipërmarrësi, këto pretendime kanë mbetur në nivel deklarativ. Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues mënyrën konkrete të likuidimit të kësteve, si dhe nuk saktësoi kohën e shlyerjes së tyre, duke mos arritur të japë shpjegime bindëse në mbështetje të pretendimit se likuidimi i kështit të parë dhe kështit të dytë nuk është kryer sipas përcaktimeve të kontratës së sipërmarrjes. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se, në analizën financiare lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, koha e pagesës së kështit të parë dhe kështit të dytë duhet konsideruar në përputhje me kontratën e sipërmarrjes.
65. Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me shlyerjen e kësteve të parë dhe të dytë, duke i konsideruar ato të likuiduara sipas përcaktimeve të kontratës së sipërmarrjes, konkretisht në shumën 1.500.000 lekë për kështin e parë në muajin tetor 2000, dhe në shumën 750.000 lekë për kështin e dytë në muajin nëntor 2000. Në vijim të kësaj analize, Komisioni ka përlloritur një balancë negative në shumën (-) 664.150 lekë për shlyerjen e këtyre dy kësteve, ndërsa për kështin e tretë⁹, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për likuidimin e tij.
66. Trupi gjykues konstaton se, lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për likuidimin e këtyre dy kësteve, subjekti ka deklaruar¹⁰ se ato burojnë nga shitja e apartamentit ekzistues, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.04.2001, në vlerën 1.950.000 lekë. Megjithatë, rezulton se kontrata e sipërmarrjes për apartamentin objekt shqyrtimi, është

⁹ Referuar kontratës së shitblerjes së apartamentit nr. {***}, datë 18.04.2001, parashikohet se palët kontraktuese deklarojnë se lirimi i banesës nga shtetasi Binas Nina do të bëhet më datë 30.09.2001, datë e cila është konsideruar si data e fillimit të banimit në apartamentin e porositur sipas kontratës së sipërmarrjes. Shuma prej 1.750.000 lekësh rezulton nga diferenca e çmimit prej 4.000.000 lekësh sipas deklaratës së subjektit të rivlerësimit në DIPP-2003 dhe asaj të paguar për dy kështet e para në muajt tetor dhe nëntor 2000.

¹⁰ Burimi i deklaruar fillimisht në vitin 2003 dhe në deklaratën vetting, ka qenë nga të ardhurat nga shitja e dy apartamenteve ekzistuese, ndërsa nëpërmjet përgjigjeve në pyetësorin nr. 2, datë 30.07.2021, ka deklaruar se ka përdorur si burim shitjen e apartamentit ekzistues në vitin 2001, shtetases N. D., për shlyerjen e dy kësteve të para.

lidhur më datë 18.10.2000 dhe në të është përcaktuar se porositësi ka likuiduar shumën 1.500.000 lekë jashtë zyrës noteriale, ndërsa kësti i dytë në shumën 750.000 lekë do të paguhej brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i saj. Në këto kushte, konstatohet një mospërputhje lidhur me momentin e shlyerjes së këtyre kësteve dhe momentin e disponimit të të ardhurave nga shitja e apartamentit ekzistues, të cilat subjekti pretendon se janë përdorur që në muajin tetor të vitit 2000, ndonëse kontrata e shitjes së apartamentit ekzistues është realizuar më datë 18.04.2001, rreth gjashtë muaj pas nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.

67. Në lidhje me këtë mospërputhje, subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në ankim, ka pretenduar se, ndonëse kontrata e shitjes është lidhur më datë 18.04.2001, pagesa për shitjen e apartamentit është përfituar prej tij që në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për apartamentin objekt shqyrtimi dhe se ky fakt provohet nga vetë përmbajtja e kontratës së shitjes.
68. Referuar këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se, nga përmbajtja e kontratës së shitjes, rezulton se palët Binas Nina në cilësinë e shitësit dhe N. D. në cilësinë e blerëses, kanë deklaruar se pasuria e përshkruar shitet kundrejt çmimit prej 1.950.000 lekësh, vlerë e deklaruar si e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Megjithatë, kjo kontratë nuk përmban asnjë të dhënë konkrete lidhur me kohën e likuidimit të këtij çmimi në mënyrën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nuk përmban referime për parapagim të çmimit sipas pretendimit të tij. Për rrjedhojë, vetëm fakti që palët kanë deklaruar se çmimi është likuiduar jashtë zyrës noteriale nuk provon, në vetvete, se kjo shumë është shlyer në kohën e pretenduar nga subjekti.
69. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2021, të shtetasës N. D., e cila ka deklaruar se, për shkak të marrëdhënieve shoqërore me bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, ka parapaguar shumën 1.500.000 lekë si pjesë të çmimit të blerjes së apartamentit, ndërsa diferenca prej 450.000 lekësh do të likuidohet në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes. Sipas deklaruësës, nënshkrimi i kontratës është vonuar për shkak të pamundësisë së saj për të likuiduar menjëherë diferencën e mbetur të çmimit në shumën 450.000 lekë.
70. Kjo deklaratë noteriale, e pashoqëruar me prova të tjera, në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit¹¹, vlerësohet e pamjaftueshme për të provuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kohën e përfitimit të shumës 1.950.000 lekë, pasi, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk rezulton asnjë e dhënë që të provojë parapagimin e shumës 1.950.000 lekë rreth gjashtë muaj përpara nënshkrimit të kontratës së shitjes.
71. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit të ardhurat nga shitja e apartamentit ekzistues janë përfituar në periudhën tetor 2000, mbetet në nivel deklarativ. Po kështu, mbetet i paprovuar edhe pretendimi se këto të ardhura kanë shërbyer si burim për shlyerjen e këstit të parë dhe këstit të dytë sipas kontratës së sipërmarrjes. Sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të pambështetur pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare të shumës 1.950.000 lekë si burim për shlyerjen e kësteve të parë dhe të dytë.

¹¹ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1 dhe nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.

72. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1995-2002, trupi gjykues verifikoi, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën shtator 1995 – nëntor 2000¹².
73. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës sipas rajonit, trupi gjykues vlerëson se shpenzimet e përfshira në analizën financiare, përfaqësojnë vlera statistikore mesatare në nivel kombëtar. Si të tilla, duke qenë se ato përbëjnë vlera minimale jetike dhe kompensojnë në favor të subjekteve edhe diferencat e mundshme, mbeten në çdo rast nën nivelin e kostove reale të jetesës. Për rrjedhojë, shpenzimet e jetesës nuk mund të ulen nën këtë minimum në varësi të vendndodhjes së qytetit apo fshatit ku ka jetuar familja e subjektit të rivlerësimit, përveç rasteve kur provohet e kundërta me prova konkrete.
74. Trupi gjykues, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, në të cilën është mbajtur qëndrimi¹³ se shpenzimet e jetesës për gjyqtarët dhe prokurorët duhet të përlllogariten në masën 30% të të ardhurave, vlerëson se shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1995–2000, duhet të përlllogariten në masën 30% të të ardhurave¹⁴. Për rrjedhojë, në këtë analizë, ndryshe nga Komisioni, shpenzimet e jetesës rezultuan në vlerën 175.915 lekë më pak se ajo e përlllogaritur nga Komisioni, ndërsa analiza financiare për shlyerjen e dy kësteve të para mbetet me balancë negative në shumën (-) 488.236 lekë.
75. Në përfundim të kësaj analize, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë se shuma prej 1.950.000 lekësh, e përfituar nga shitja e apartamentit sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.04.2001, ka shërbyer për shlyerjen e kështit të parë dhe të dytë të pasurisë objekt shqyrtimi. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, lidhur me mundësinë financiare për likuidimin e këtyre dy kësteve, subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë negative në shumën (-) 488.236 lekë.
76. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se, në lidhje me pasurinë “apartament banimi” me sipërfaqe 106 m², të ndodhur në Elbasan, subjekti i rivlerësimit gjendet në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
77. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit sa i takon konkluzionit të Komisionit në lidhje me dëmshpërblimin 1.000.000 lekë, duke konstatuar si vijon.
78. Në lidhje me shumën e përfituar si dëmshpërblim, Komisioni¹⁵ ka arritur në përfundimin se: *Konkluzionet e rezultateve të hetimit të njoftuara subjektit të rivlerësimit për këtë pikë, nuk*

¹² Në vendimin e Komisionit, në poshtëshënimin nr. 23, është referuar se: “Komisioni ka kryer analizën duke filluar nga shtatori i vitit 1995, për sa kohë në gusht të vitit 1995, ka rezultuar se subjekti ka kryer një investim në shumën 520.000 lekë, për blerjen e apartamentit të ndodhur në lagjen “{***}”, Elbasan, me kontratën nr. {***}, datë 2.8.1995, për të cilin, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duke përfshirë të ardhurat nga pagat të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në shumën 426.001 lekë. Për rrjedhojë, Komisioni ka nisur analizën financiare pas këtij investimi.

¹³ Shih vendimin e Kolegjit nr. 15/2019 (JR), paragrafët 21.39 - 21.42.

¹⁴ Në rastin e subjektit të rivlerësimit, rezulton se ka ushtruar detyrën si prokuror për periudhën shtator 1995 - nëntor 2000.

¹⁵ Në paragrafin nr. 83 të vendimit objekt shqyrtimi.

mund të ndryshojnë, pasi Komisioni vlerëson se në këtë marrëdhënie, mungon logjika ekonomike dhe shkaku i ligjshëm mbi bazën e të cilit një person do të paguante kundërshtëpërblim për një dëm që nuk e ka shkaktuar. Për më tepër, “dëmshpërblyesi” nuk ka pasur cilësimin apo tagrin ligjor për të përfaqësuar investitorin e ndërtimit (dëmtuesin), ndërkohë që as familjari i tij nuk gëzonte më të drejta reale mbi truallin në momentin e dakordësimit të dëmshpërblyesimit të pretenduar. Në çdo rast, edhe nëse do të merrej i mirëqenë dëmshpërblyesimi i pretenduar dhe i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, shuma e përfituar nuk do të rezultonte e ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk është provuar as dëmi i pretenduar dhe as pagesa e tatimit mbi shumën e përfituar, e cila nuk rezulton të jetë ndër fitimet monetare të përjashtuara nga detyrimi tatimor. Për rrjedhojë, shuma prej 1.000.000 lekësh nuk mund të konsiderohet në analizën financiare si një burim i ligjshëm dhe i disponueshëm nga subjekti i rivlerësimit.

79. Subjekti i rivlerësimit e mbështeti shkaku e ankimit lidhur me vlerësimin e mësipërm të Komisionit për përfitimin e shumës prej 1.000.000 lekësh, në pretendimet si vijojnë.

(i) Komisioni, në kundërshtim me rolin dhe funksionin e tij, ka kryer vlerësime që nuk mbështeten në provat e administruara dhe, në shkëlqje të ligjit, ka arritur në përfundime të hamendësuar lidhur me faktin e përfitimit të shumës 1.000.000 lekë nga z. E. K..

(ii) Komisioni, duke e konsideruar përfitimin e dëmshpërblyesimit si veprim fiktiv, me argumentin se mungon shkaku real apo arsyeja e ligjshme e dëmit të pretenduar, ka vënë në diskutim përmbajtjen e akteve të nënshkruara me vullnet të lirë, të cilat kanë fuqi ligjore dhe për të cilat subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të besueshme.

(iii) Z. E. K. legjitimohej dhe kishte interes të ligjshëm për pagesën e dëmshpërblyesimit, pasi vijonte të kishte të drejta reale mbi truallin shesh ndërtimi. Gjithashtu, ndonëse ai nuk bënte pjesë në kategorinë e personave të tjerë të lidhur, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të provuar aftësinë paguese të tij, sipas dokumentacionit ligjor të depozituar pranë Komisionit, i cili kishte mundësinë ta thërriste z. E. K. për pyetje.

(iv) Në rezultatet e hetimit, Komisioni ka arritur fillimisht në përfundimin se z. E. K. ndodhej në pamundësi financiare për dhënien e shumës 1.000.000 lekë, ndërkohë që, pasi u provua mundësia financiare e këtij shtetasi për dhënien e kësaj shume, Komisioni ka kaluar në vlerësime mbi ekzistencën e dëmit të shkaktuar, pa prova kundërshtuese dhe jashtë diskrecionit që i njeh ligji.

(v) Është provuar interesi i znj. L. K. që subjekti i rivlerësimit të hiqte dorë nga padia, pasi, sipas aktit të ekspertimit të vitit 2007, të administruar në seancë dëgjimore, pallati që do të ndërtohej ishte vlerësuar në shumën 1.025.650 euro, çka, sipas subjektit të rivlerësimit, tregon se znj. L. K. kishte interes të ofronte shumën 1.000.000 lekë, me qëllim heqjen dorë nga pretendimet për dëmet që do t'i shkakttoheshin nga ndërtimi i objektit.

(vi) Konkluzioni i Komisionit, referuar nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është i gabuar, pasi subjekti i rivlerësimit pretendon se, në cilësinë e përfituesit të së ardhurës, nuk ka pasur detyrimin për pagimin e detyrimeve tatimore, për sa kohë kjo e ardhur nuk parashikohej në nenin 8/1 të ligjit të sipërcituar, duke qenë se

shuma është përfituar si shpërblim dëmi në kuadër të një procesi gjyqësor dhe, për rrjedhojë, nuk hyn në kategorinë e të ardhurave të tatueshme.

80. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, referuar akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton si vijon.
81. Në DIPP-në e vitit 2007, si dhe në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura në shumën 1.000.000 lekë, të përfituara si dëmshpërblim, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.09.2007. Referuar përmbajtjes së kësaj deklarate, shtetasi E. K. ka deklaruar se: *Jam pronar i një trualli së bashku me nënën time, L. K., i ndodhur në lagjen “{***}”, rruga “{***}”, truall për të cilin kemi marrë leje ndërtimi për një pallat 8-katësh (bodrum + shtatë kate banim + një kat lokal, plus papafingo), përbri nga ana lindore e pallatit ku banon deklaruesi Binas Nina (aktualisht në katin e {***} banim). Unë, si deklarues, meqenëse kam marrë lejen e sheshit të ndërtimit për pallatin e sipërcituar, sipas parametrave të përcaktuar në hartën që do t’i bashkëngjitet kësaj deklarate, dhe për shkak se deklaruesit Binas Nina i shkaktoj një dëm në shumën 1.000.000 lekësh, jam dakord t’ia shlyej këtë dëm dhe t’ia jap në dorë cash. Nga ky moment, unë dhe deklaruesi nuk kemi më asnjë problem ndërmjet nesh dhe nuk kam më dëm për të shlyer.*
82. Në të njëjtën deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Unë, Binas Nina, deklaroj se jam dakord me deklaratimet e z. E. K. dhe se është e vërtetë që kam marrë prej tij shumën 1.000.000 lekë si kundërshtim për dëmin që më shkaktohet nga ndërtimi i pallatit sipas planvendosjes dhe lejes së sheshit të ndërtimit, të cilat do t’i bashkëngjiten kësaj deklarate. Pas kësaj date, unë nuk kam më asnjë detyrim ndaj tij dhe as ai ndaj meje. Ai do të vazhdojë ndërtimin sipas dokumentacionit dhe legjislacionit në fuqi për ndërtimet e reja dhe unë heq dorë nga e drejta e padisë për pengimin apo shfuqizimin e aktit administrativ të dhënies së lejes së ndërtimit dhe akteve të mëvonshme që rrjedhin prej saj.*
83. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni e ftoi subjektin e rivlerësimit të shpjegonte dinamikën e ngjarjes dhe të gjykimit të iniciuar prej tij nëpërmjet një kërkesëpadie, si dhe të paraqiste dokumentacionin provues lidhur me ndërtimin e pallatit dhe pronësinë mbi truallin.
84. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Leja e ndërtimit ishte dhënë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në legjislacionin urbanistik, pasi ndërtimi do të afrohej pranë dritareve dhe ballkonit të apartamentit tim, duke cenuar të drejtën time kushtetuese për gëzimin e lirë të pronës, si dhe duke penguar ndriçimin dhe privatësinë. Gjithashtu, ndërtimi ishte parashikuar me dritare nga ana e apartamentit tim, ku unë disponoj dritare dhe ballkon. Në këto kushte, iu drejtova Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesëpadi. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, shtetasi E. K. më kërkoi të hiqja dorë nga padia dhe të pranonte kompensimin e dëmit të pësuar prej meje. Me marrëveshje ndërmjet palëve, ramë dakord që dëmi të kompensohej në shumën 1.000.000 lekë dhe ai të vijonte ndërtimin.*
85. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit vendimin nr. {***}, datë 11.11.2005, të KRRT-së Elbasan, për miratimin e sheshit të ndërtimit për znj. L. K., për objektin “Bodrum + 8 kate + papafingo”, në truallin me vërtetim pronësie

nr. {***}, me sipërfaqe 545 m², vërtetimin hipotekor të pasurisë së shtetases L. K., nëna e shtetasit E. K., si dhe kërkesëpadinë dhe vendimin gjyqësor përkatës¹⁶.

86. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë fotografi të ndërtimit në fjalë, si dhe dokumentacionin ligjor që provon kohën e shlyerjes së këtij kundërshpërblimi dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë mundësuar dhënien e shumës përkatëse. Në përgjigje të këtyre kërkesave, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur fotografi aktuale të objektit, nga të cilat rezulton se ndërtimi i godinës nuk ka përfunduar dhe nuk është afruar pranë dritareve apo ballkonit të banesës së subjektit në një masë të tillë që të krijonte pasoja apo dëme reale dhe konkrete për të.
87. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Bashkëshortja e z. K. ka qenë e regjistruar si biznes privat që nga viti 2003 dhe, sipas DRT Elbasan, ajo është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT {***}. Për vitin 2005, ka deklaruar të ardhura në shumën 3.700.000 lekë dhe, për vitin 2006, ka deklaruar të ardhura në shumën 4.500.000 lekë. Familja e z. K. ka pasur burime të ligjshme financiare për shumën 1.000.000 lekë që më është dhënë si kundërshpërblim dëmi.*
88. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin nr. {***} prot., datë 19.08.2021, të DRT Elbasan, për shtetasen V. K., person fizik dhe bashkëshortja e shtetasit E. K., ku pasqyrohen të dhëna mbi të ardhurat e deklaruara nga shitja e mallrave dhe/ose shërbimeve për vitet 2005 dhe 2006.
89. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, duke arsyetuar se veprimi në fjalë paraqet indicie fiktiviteti, për shkak të mungesës së një arsyeje apo shkakut real të dëmit të pretenduar, për sa kohë ndërtimi në fjalë ende nuk ka përfunduar dhe nuk është provuar, me dokumentacion ligjor, burimi i ligjshëm i të ardhurave që kanë mundësuar dhënien e shumës prej 1.000.000 lekësh nga shtetasi E. K..
90. Komisioni ka vlerësuar gjithashtu se, edhe në rast se do të provoheshin kushtet e mësipërme, në mungesë të provës për ekzistencën e një dëmi pasuror konkret dhe real të pësuar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe duke pasur parasysh se kjo shumë është përfituar në bazë të një dakordësimi vullnetar ndërmjet palëve, referuar nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e përfituesit të të ardhurës, ka pasur detyrimin për pagimin e detyrimeve tatimore përkatëse mbi shumën e përfituar. Sipas Komisionit, kjo e ardhur nuk përfshihet në kategorinë e të ardhurave të përjashtuara nga tatimi, të parashikuara në nenin 8/1 të ligjit të sipërcituar.
91. Në vijim, Komisioni ka ngritur dyshime se mënyra e përfitimit të kësaj shume i ngjan më tepër një dhurimi apo huadhënieje të kamufluar dhe/ose një tentative fiktiviteti për të justifikuar një të ardhur me burim tjetër, për sa kohë, përveç mungesës së qartësisë mbi parametrat e

¹⁶ Referuar dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi A. Ç. kanë depozituar kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan për anulimin e lejes së ndërtimit dhe marrjen e masës së sigurimit për ndërtimin e pallatit 8-katësh nga L. K.. Në lidhje me këtë kërkesëpadi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 13.9.2007, ka vendosur pushimin e gjykimit, pasi subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë nga gjykimi, ndërsa paditësi tjetër nuk është paraqitur. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 17.09.2007.

vlerësimit të dëmit të pretenduar, në këtë marrëdhënie mungon logjika ekonomike dhe shkak i mirëfilltë mbi bazën e të cilit një person do të paguante një shumë të konsiderueshme si kundërshpërblim për një dëm që ende nuk ishte shkaktuar realisht prej tij. Për rrjedhojë, Komisioni ka vlerësuar se shuma prej 1.000.000 lekësh nuk mund të konsiderohej me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, nuk e ka përfshirë atë në analizën financiare.

92. Referuar sa më sipër, për sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni, në kundërshtim me rolin dhe funksionin e tij, ka kryer vlerësime që nuk mbështeten në provat e administruara dhe, në shkelje të ligjit, ka arritur në përfundime të hamendësuara lidhur me përfitimin e shumës 1.000.000 lekë, trupi gjykues vëren se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni në lidhje me këtë të ardhur të pretenduar në formën e kundërshpërblimit, është zhvilluar në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, si dhe me qëllimin e procesit të rivlerësimit.
93. Në rastin konkret, rezulton e nevojshme analiza e ekzistencës së marrëdhënies së detyrimit ndërmjet shtetasit E. K. dhe subjektit të rivlerësimit, duke vlerësuar ekzistencën e shkakut të ligjshëm mbi bazën e të cilit shtetasi E. K. do të duhej të paguante një dëm të pretenduar të shkaktuar subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 608 të Kodit Civil.
94. Nga verifikimi i akteve, trupi gjykues konstaton se, ndonëse subjekti i rivlerësimit pretendon ekzistencën e një dëmi, me argumentin se leja e ndërtimit ishte dhënë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni urbanistik dhe se ndërtimi do të afrohej pranë dritareve dhe ballkonit të banesës së tij, duke cenuar të drejtën për gëzimin e lirë të pronës, si pasojë e pengimit të ndriçimit dhe privatësisë, ardhja e dëmit, si kushti i parë për lindjen e marrëdhënies së detyrimit ndërmjet palëve, nuk provohet të ketë ndodhur.
95. Në këtë drejtim, nga fotografitë e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se ndërtimi i objektit nuk ka përfunduar dhe, për rrjedhojë, dëmi i pretenduar nuk ka ardhur realisht. Po kështu, nuk provohet as ekzistenca e paligjshmërisë së lejes së ndërtimit, pasi, megjithëse subjekti i rivlerësimit ka pretenduar shkelje të kushteve urbanistike, ai nuk ka paraqitur gjatë hetimit administrativ dokumentacion provues në këtë drejtim, si: akt ekspertimi, vendim gjykate apo akt të ndonjë institucioni tjetër kompetent, që të ketë konstatuar pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit apo pezullimin e punimeve për shkakun e pretenduar prej tij.
96. Përkundrazi, rezulton se, edhe pse leja fillestare e ndërtimit nuk është ekzekutuar nga shoqëria ndërtuese në përputhje me planin ndërtimor dhe projektin e miratuar, për të njëjtin objekt është dhënë një tjetër leje ndërtimi në favor të pronarit të ri të sheshit të ndërtimit në vitin 2007.
97. Po ashtu, trupi gjykues konstaton se, në momentin e dhënies së vendimit të pushimit të gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe në kohën e nënshkrimit të deklaratës noteriale lidhur me kundërshpërblimin, pronar i ligjshëm i truallit ka qenë shtetasi A. B.. Ndërkohë, znj. L. K., nëna e shtetasit E. K., rezulton se kishte hequr dorë nga pronësia mbi truallin, duke e shitur atë dhe, për rrjedhojë, kishte hequr dorë edhe nga realizimi i ndërtimit të objektit.

98. Referuar faktit se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë kundërshtim në DIPP-në e vitit 2007, deklarim i cili mbështetet edhe nga deklarata noteriale, dokument i përpiluar përpara noterit dhe i regjistruar në regjistrat publikë në kohën e përfitimit të këtyre të ardhurave, si dhe duke mbajtur në konsideratë se subjekti i rivlerësimit ka iniciuar një proces gjyqësor për anulimin e lejes së ndërtimit, me pretendimin se banesa e tij cenohej nga ndërtimi i objektit në fjalë, trupi gjykues vlerëson se këto rrethana përbëjnë indicie të ekzistencës së një mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve lidhur me ndërtimin e objektit.
99. Në këtë kuadër, ndonëse mosmarrëveshja nuk rezulton të jetë zgjidhur nëpërmjet procesit gjyqësor të iniciuar nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të përjashtohet mundësia që palët të jenë dakordësuar jashtëgjyqësisht, sipas deklarimeve të tyre në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.09.2007, dhe që, në këtë mënyrë, subjekti i rivlerësimit të ketë përfituar realisht shumë e deklaruar prej tij, në përputhje me detyrimet që burojnë nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar. Kjo zgjidhje jashtëgjyqësore e konfliktit mes palëve, ka prodhuar si pasojë edhe tërheqjen e paditësit, subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i padisë civile që pretendonte cenim të të drejtave të pronësisë prej ndërtimit që kishte nisur.
100. Trupi gjykues vlerëson se, ndonëse në kohën e lidhjes së kësaj marrëveshjeje për zgjidhjen jashtëgjyqësisht të një konflikti civil, pronësia mbi tokën nuk ishte më në favor të palës së paditur, kjo palë, si garantuese e të drejtave të tjetërsuara mbi pasurinë, kishte interes të ligjshëm të zgjidhte konfliktet e mundshme që mund të shqetësonin pronarët e rinj, siç ishte edhe ai me subjektin e rivlerësimit. Në këtë kuptim, trupi gjykues e vlerëson të besueshëm dhe të ligjshëm faktin e arritjes së marrëveshjes të materializuar në deklaratën noteriale të vitit 2007, nëpërmjet së cilës subjekti kishte përfituar shumë prej 1.000.000 lekësh.
101. Në vlerësimin e trupit gjykues, legjislacioni tatimor i kohës nuk ka pasur qartësi lidhur me tatimin e një të ardhure atipike, siç rezulton ajo e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, në një vlerësim garantist, u pranua pretendimi i subjektit të rivlerësimit për ta përfshirë atë si të ardhur në analizën financiare të vitit 2007, kur deklarohet se është përfituar. Përfshirja e kësaj e ndryshon balancën negative të përlllogaritur nga Komisioni për vitin 2007, e cila, gjithsesi, nuk rezulton përcaktuese për vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë për arsye që do të trajtohen në vijim, lidhur me analizën e depozitës në Raiffeisen Bank.
- *Lidhur me depozitën e kursimit në vlerën 11.078 euro në Credins Bank:*
102. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë bono thesari, e cila është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit se është tërhequr në vitin 2010 dhe ka shërbyer për krijimin e depozitës 11.078 euro në Credins Bank, si dhe të konkluzionin tjetër të Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e depozitës 1.682.812 lekë në Credins Bank, e investuar për herë të parë në datën 09.01.2006, e cila është deklaruar gjithashtu nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi i depozitës bankare objekt analize.

103. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burime për krijimin e kësaj depozite¹⁷, kanë shërbyer: (i) tërheqja e bonove të thesarit në shumën 800.000 lekë në vitin 2010; (ii) mbyllja e depozitës bankare pranë Credins Bank në shumën 1.685.812 lekë; dhe (iii) interesat bankarë në shumën 1.078 euro.
104. Komisioni, në vendimin e tij lidhur me burimet e krijimit të investimit në bono thesari në shumën 800.000 lekë, ka arritur në përfundimet se, për kryerjen e investimit në shumën 500.000 lekë në depozitë pranë Bankës së Kursimeve, e cila më pas ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë bono thesari, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në të njëjtën shumë, pra 500.000 lekë.
105. Në lidhje me burimet e krijimit të depozitës në shumën 1.685.812 lekë pranë Credins Bank, Komisioni ka konkluduar se: *Edhe pse deklarimi për vitin 2005 është kryer gjatë tremujorit të parë të vitit 2006, lëvizjet bankare tregojnë se tërheqja në fjalë është regjistruar në datën e kryerjes së veprimit, konkretisht më 30.12.2005, datë në të cilën është realizuar realisht [...] Ndërsa, për sa i përket analizës financiare, si pasojë e pranimit të disa prej pretendimeve të subjektit, të cilat trajtohen veçmas në analizën financiare, konkluzionet e njoftuara subjektit për këtë pikë, ndonëse nuk ndryshojnë në thelb, kanë sjellë një pakësim minimal të balancës negative për krijimin e kursimeve cash në fund të vitit 2006, konkretisht nga vlera 552.492 lekë, e njoftuar në rezultatet e hetimit administrativ, në vlerën përfundimtare 545.891 lekë.*
106. Në kundërshtimin si të gabuar të konkluzioneve të mësipërme, sa u takon burimeve të krijimit të bonove të thesarit në shumën 800.000 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim si vijon.
107. Fragmentarizimi nga Komisioni i kësteve të blerjes së apartamentit për periudhën para vitit 2003, ka ndikuar drejtpërdrejt në përlogaritjen e mundësisë financiare për krijimin e depozitës bankare objekt shqyrtimi. Ai pretendon se lëvizjet në llogaritë bankare, të ardhurat nga pagat dhe burimet e tjera financiare, si dhe shpjegimet e dhëna prej tij, provojnë se familja e tij ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite.
108. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shuma prej 500.000 lekësh, e depozituar në Bankën e Kursimeve nga bashkëshortja e tij, është krijuar nga të ardhurat e familjes për periudhën 1995–2000, të cilat, sipas tij, kanë qenë në shumën 2.206.084 lekë, vlerë e mjaftueshme për krijimin e depozitës në fjalë. Po ashtu, ai ka deklaruar se, për blerjen e apartamentit, ka deklaruar edhe burimin e të ardhurave, ku vetëm shuma 150.000 lekë ka pasur burim nga pagat, ndërsa pjesa tjetër ka ardhur nga shitja e apartamentit të mëparshëm.
109. Subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se Komisioni ka mbajtur një qëndrim kontradiktor lidhur me burimin e të ardhurave të ligjshme, pasi, nga njëra anë, ka vlerësuar se ai ka provuar mjaftueshëm të ardhura, ndërsa, nga ana tjetër, ka konkluduar se subjekti gjendet në mungesë totale të burimeve financiare në shumën 500.000 lekë.

¹⁷ Depozituar fillimisht cash në datën 6.12.2010, shuma 17.000 euro, me përshkrimin: “Derdhje nga Binas Nina, çelje depozite 3-mujore”. Nga kjo shumë, është tërhequr më datë 7.9.2011, shuma 7.000 euro dhe, ndër vite, është shtuar me interesat shuma prej 1.078 eurosh.

110. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi dhe në konsideratë të konkluzioneve të Komisionit lidhur me burimet e krijimit të depozitës së kursimit në vlerën 11.078 euro pranë Credins Bank, trupi gjykues konstaton si në vijim.
111. Në lidhje me bonot e thesarit në shumën 800.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*: *këto bono thesari janë depozituar në vitin 2006. Bonot e thesarit 800.000 lekë në vitin 2006, janë krijuar nga: pakësim i pagës së patërhequr në Raiffeisen Bank, Binas Nina në shumën 344.881 lekë, deklaruar si shtesë në deklarin e pasurisë së vitit 2005; pakësim i pagës së patërhequr në Raiffeisen Bank, F. N. në shumën 90.879 lekë, deklaruar si shtesë në deklarin e pasurisë së vitit 2005. Pjesa tjetër është krijuar si pasojë e tërheqjes së depozitës së kursimit 565.467 lekë në Raiffeisen Bank, para vitit 2003 dhe e deklaruar si gjendje në deklarin e pasurisë në vitin 2003 (500.000 lekë + interesat bankarë).*
112. Komisioni ka konstatuar se, referuar analizës financiare, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për realizimin e investimeve dhe shpenzimeve të kryera gjatë vitit 2000, konkretisht për investimin në dy pasuri të paluajtshme dhe për krijimin e depozitës së kursimit në shumën 500.000 lekë po në vitin 2000. Sipas Komisionit, kjo shumë është përdorur më pas për investimin në bono thesari në Bankën e Shqipërisë në vitin 2006, të cilat më tej kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës pranë Credins Bank në vitin 2010, në shumën 17.000 euro.
113. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me mundësinë e krijimit të depozitës bankare në Raiffeisen Bank, prej 500.000 lekësh, në vitin 2000, e përdorur për investimin në bono thesari në shumën 800.000 lekë në vitin 2006, të cilat më pas kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës në shumën 17.000 euro pranë Credins Bank në vitin 2010, lidhet drejtpërdrejt me analizën financiare të kryer për vitin 2000.
114. Në muajt tetor dhe nëntor të vitit 2000, subjekti i rivlerësimit ka bërë pagesa lidhur me pasurinë “apartament” me sipërfaqe 106 m² në Elbasan, si dhe një pagesë në shumën 500.000 lekë në muajin maj të vitit 2000 për një tjetër pasuri të paluajtshme, të llojit “apartament”. Referuar analizës financiare të kryer në Kolegj nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh financiare për shlyerjen e dy kësteve të para të pasurisë “apartament” në shumën (-) 488.236 lekë. Për rrjedhojë, edhe depozita në Bankën e Kursimeve në vitin 2000, në shumën 500.000 lekë, rezulton të jetë krijuar në mungesë të burimeve të ligjshme financiare.
115. Në këto kushte, trupi gjykues, njësoj si Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare në shumën 500.000 lekë për krijimin e pasurisë “bono thesari” në vlerën 800.000 lekë.
116. Në vijim, trupi gjykues mori në analizë burimet e krijimit të depozitës në shumën 1.685.812 lekë në Credins Bank, duke konstatuar si vijon.
117. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se tërheqja nga depozita e kursimit pranë Raiffeisen Bank, në shumën 565.467 lekë, e kryer më datë 30.12.2005, nuk është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2005, por në atë të vitit 2006, duke pasqyruar në formularin e deklarin edhe datën e pakësimit, konkretisht datën 30.12.2005. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky deklarim është bërë me qëllim respektimin e dokumentacionit bankar, pasi veprimet e kryera në ditët e

fundit të vitit pasqyroheshin nga banka me datat e fillimit të vitit pasardhës. Në këto kushte, ai pretendon se shuma prej 565.467 lekësh nuk është përfshirë në gjendjen *cash* të vitit 2005.

118. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se, nëse kjo shumë do të përfshihej në analizën financiare, do të rezultonte se ai ka pasur mundësi financiare për kryerjen e investimit në shumën 1.300.000 lekë, si dhe për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 1.400.000 lekë në fund të vitit 2006.
119. Në lidhje me tërheqjen e likuiditeteve nga depozita e bashkëshortes së tij pranë Raiffeisen Bank, më datë 28.03.2006, dhe deklarimin e kësaj shume si burim për krijimin e investimit në muajin janar të po atij viti, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se deklarimi periodik është kryer brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës dhe se, në momentin e kryerjes së investimit, është përdorur gjendja *cash* e disponuar në banesë. Sipas tij, shuma e investuar është tërhequr më pas nga depozita pranë Raiffeisen Bank, me qëllim rivendosjen e gjendjes *cash* të përdorur më parë.
120. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstaton si vijon.
121. Kjo depozitë është investuar për herë të parë më datë 09.01.2006, kur subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën 1.300.000 lekë në llogarinë e tij pranë Credins Bank¹⁸. Si burim për krijimin e kësaj shume, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*, fondet e tërhequra nga bashkëshortja e tij nga depozita pranë Raiffeisen Bank, në shumën 679.724 lekë, depozitë e krijuar në vitin 2000.
122. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo shumë përfaqëson: *pakësim i depozitës së kursimit në Raiffeisen Bank, në shumën 679.724 lekë, krijuar në këtë bankë në vitin 2000 dhe e deklaruar në deklaratën e vitit 2003, në shumën 560.000 lekë + interesat.*
123. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shuma prej 565.467 lekësh, është tërhequr më datë 30.12.2005 dhe nuk është deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2005¹⁹, trupi gjykues vlerëson se, në konsideratë të faktit që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësimin e kësaj depozite në DIPP-në e vitit 2006, si dhe duke pasur parasysh se nga tërheqja e shumës nga depozita pranë Raiffeisen Bank deri në krijimin e depozitës më datë 09.01.2006, kanë kaluar vetëm 9 ditë, u vlerësua i besueshëm pretendimi i subjektit se kjo shumë ka shërbyer si burim për investimin e depozitës prej 1.300.000 lekësh më datë 09.01.2006.
124. Për rrjedhojë, nga përfshirja e shumës prej 565.467 lekësh si burim për krijimin e depozitës në vlerën 1.300.000 lekë, analiza financiare për krijimin e kësaj depozite, rezulton pozitive, duke shëruar balancën negative të konstatuar nga Komisioni në lidhje me investimin në shumën 1.300.000 lekë, i cili ka shërbyer më pas si burim për krijimin e depozitës pranë Credins Bank.
125. Sa më sipër, ndikon edhe në analizën financiare të periudhës 09.01.2006 – 31.12.2006, lidhur me mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* në shumën 1.400.000 lekë deri në fund të vitit 2006.

¹⁸ Shumë e cila ka qëndruar si depozitë në këtë bankë deri në datën 08.11.2010, duke arritur në vlerën 1.685.812 lekë bashkë me interesat e përfitur.

¹⁹ Faqja nr.13 e ankimit të subjektit.

Në këtë rast, analiza financiare rezulton me balancë negative në shumën (-) 116.720 lekë, ndryshe nga analiza e Komisionit, i cili kishte përlllogaritur balancë negative në shumën (-) 552.492 lekë.

126. Pavarësisht sa më sipër, referuar konkluzionit të arritur më herët në këtë vendim, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e bonove të thesarit në vlerën 800.000 lekë, të cilat kanë shërbyer si një ndër burimet për krijimin e depozitës objekt shqyrtimi, trupi gjykues arrin në përfundimin se, lidhur me depozitën e kursimit në vlerën 11.078 euro pranë Credins Bank, subjekti i rivlerësimit gjendet në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Në lidhje me llogarinë rrjedhëse të subjektit të rivlerësimit në vlerën 1.449.759 lekë, në Raiffeisen Bank:*

127. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit se: *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ka depozituar deklaratë pranë Inspektoratit, lidhur me saktësimin e kësaj shume, Komisioni vëren se kjo deklaratë nuk përmban elementet formale të depozitimit pranë këtij institucioni, pasi nuk është e pajisur me numër protokolli, datë dhe vit, si dhe informacioni dhe saktësimi i kërkuar nga subjekti i rivlerësimit nuk është reflektuar në deklarin pasardhës të subjektit, sikurse ka ndodhur për raste të tjera. Gjithsesi, Komisioni vlerëson të theksojë se, në të gjitha rastet, për sa kohë nuk janë konsideruar si të ligjshme të ardhurat në masën 1.000.000 lekë nga kundërshpërblimi, njohja e kursimeve në vitin 2007 do të krijonte të njëjtën balancë negative në vitin 2007, duke bërë që rezultati total i analizës financiare të mos ndryshonte edhe nëse do të merrej në konsideratë ky version i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.*
128. Në kundërshtim të këtij konkluzioni, subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se Komisioni ka konstatuar pamjaftueshmëri financiare, duke iu referuar një analize financiare të kryer në mënyrë të cunguar, pasi shuma prej 1.000.000 lekësh, e përfituar si kundërshpërblim në vitin 2007, përbën të ardhur me burim të ligjshëm dhe duhej të përfshihej në analizën financiare. Sipas subjektit, kjo shumë përfaqëson kundërshpërblim për një dëm të prekshëm, të mundshëm dhe real, të përcaktuar me marrëveshje ndërmjet dëmtuesit dhe të dëmtuarit. Për ekzistencën e këtij dëmi dhe vlerën e paguar për të, në vitin 2007 është hartuar deklarata noteriale e shtetasit E. K., dokument i krijuar në një kohë kur koncepti i *vetting*-ut nuk ekzistonte.
129. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se DIPP-ja e vitit 2007 nuk është interpretuar në përputhje me dokumentacionin e administruar pranë ILDKPKI-së, pasi nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të viteve 2007 dhe 2008, provohet, sipas tij, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se shuma prej 1.000.000 lekësh ka qenë gjendje *cash* në banesë në fund të viteve 2007 dhe 2008, si dhe në vijim.
130. Në DIPP-në e vitit 2008, të dorëzuar më datë 25.03.2009, subjekti ka bashkëlidhur dokumentin “Deklaratë drejtuar ILDKPKI-së nga subjekti i rivlerësimit Binas Nina”, së bashku me dokumentet shoqëruese. Në faqen e parë të kësaj deklarate periodike, subjekti i ka kërkuar ILDKPKI-së që shuma prej 1.000.000 lekësh, e marrë si kundërshpërblim nga z. E. K. dhe e deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 gabimisht me emërtimin “bono thesari, Banka

Kombëtare Tregtare”²⁰, në pikën 2 të faqes 3 të deklarimit periodik, të korrigjohej duke zëvendësuar këtë emërtim me “shtesë lekësh gjendje në banesë”. Sipas subjektit, ILDKPKI-ja e ka administruar këtë deklaratë duke e bërë pjesë të deklarimit periodik dhe nuk ka konstatuar parregullsi apo pamjaftueshmëri në deklarimet periodike të viteve 2007 dhe 2008.

131. Subjekti i rivlerësimit pretendoi më tej se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit, njohja e këtij kursimi në vitin 2007 do të përmirësonte balancën e vitit 2016 dhe do të përkeqësonte balancën e vitit 2007 me të njëjtën shumë, duke bërë që rezultati i analizës financiare të mbetej i pandryshuar, është pa logjikë financiare. Sipas subjektit, gjatë vitit 2007, ai nuk ka krijuar pasuri tjetër, përveç depozitimit të shumës prej 500.000 lekësh në bono thesari dhe kursimeve *cash* në vlerën 200.000 lekë, ndërkohë që të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet familjare gjatë këtij viti. Për rrjedhojë, sipas tij, nuk ka ekzistuar nevoja për përdorimin e shumës prej 1.000.000 lekësh, ndaj njohja e këtij kursimi për vitin 2007, nuk do të sillte përkeqësim të balancës financiare për këtë vit.
132. Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike ndër vite dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me gjendjen *cash* të disponuar në banesë, trupi gjykues konstaton si vijon.
133. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar depozitimin në bankë të shumës prej 1.450.000 lekësh²¹, si dhe njëkohësisht pakësimin e gjendjes *cash* në banesë me të njëjtën shumë.
134. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të njëjtin burim lidhur me këtë pasuri, duke specifikuar edhe shtesat dhe pakësimet e gjendjes *cash* ndër vite, konkretisht: në vitin 2004 – shtesë në shumën 800.000 lekë; në vitin 2005 – shtesë në shumën 300.000 lekë; në vitin 2006 – shtesë në shumën 300.000 lekë; në vitin 2007 – shtesë në shumën 1.200.000 lekë; në vitin 2008 – pakësim në shumën 300.000 lekë; në vitin 2009 – pakësim në shumën 1.200.000 lekë; dhe në vitin 2010 – shtesë në shumën 400.000 lekë. Subjekti ka sqaruar gjithashtu se shtesat e deklaruara prej tij kanë buruar nga të ardhurat nga pagat, me përjashtim të vitit 2007, kur nga shuma 1.200.000 lekë e deklaruar si shtesë, shuma prej 1.000.000 lekësh ka pasur si burim kundërshtëpërblimin e përfituar.
135. Referuar DIPP-së së vitit 2007, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë deklaruar si shtesë *cash* (lekë në banesë) shumën prej 200.000 lekësh dhe jo shumën prej 1.200.000 lekësh, sikurse është specifikuar në deklaratën *vetting*. Ndërkohë, shuma prej 1.000.000 lekësh e përfituar nga kundërshtëpërblimi, është deklaruar nga subjekti vetëm në rubrikën e të ardhurave të vitit, pa u specifikuar mbartja e kësaj shume si gjendje *cash*.
136. Komisioni, për vitin 2007, nuk e ka përfshirë në analizën financiare shumën prej 1.000.000 lekësh të pretenduar si të përfituar nga kundërshtëpërblimi, me arsyetimin se kjo shumë nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme dhe, po ashtu, nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti si gjendje *cash* në fund të këtij viti.

²⁰ Shënimi në faqen 1 në DIPP-në e vitit 2008, është: “Bashkëngjitur deklaratës, datë 25.03.2009, faqe 2 (dy), vërtetim BKT nr. {***}, datë 24.03.2009, vërtetim bono thesari, datë 5.07.2007 (fotokopje), vërtetim bono thesari, datë 17.01.2008 (fotokopje)”.

²¹ Kjo shumë është depozituar *cash* në llogarinë në Raiffeisen Bank të subjektit të rivlerësimit në datën 11.10.2016. Nga viti 2011 e në vijim, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar më ndryshime të gjendjes *cash* deri në vitin 2016, kur është deklaruar depozitimi i shumës 1.450.000 lekë.

137. Trupi gjykues e gjen të drejtë konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e vitit 2007, nuk e ka deklaruar si gjendje *cash* shumën prej 1.000.000 lekësh të pretenduar si të përfituar nga kundërshpërblimi. Kolegji, në jursiprudencën e tij, ka mbajtur qëndrimin²² se bazuar në nenin 4, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash*, llogaritë rrjedhëse, depozitat, bonot e thesarit dhe huadhëniet, në lekë ose në valutë të huaj. Në kuptim të kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte rregullisht gjendjen e likuiditeteve, me qëllim mundësimin e kontrollit të tyre.
138. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se deklarinimet e interesave privatë dhe pasurorë të paraqitura më parë pranë ILDKPKI-së mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji.
139. Referuar DIPP-së së vitit 2007, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë *cash* shumën prej 200.000 lekësh, ndërsa shumën prej 1.000.000 lekësh të përfituar nga kundërshpërblimi e ka deklaruar vetëm si të ardhur dhe jo si kursim apo gjendje *cash* të mbartur.
140. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se, më datë 25.03.2009, nëpërmjet një shënimi të lënë në DIPP-në e vitit 2008, i ka kërkuar ILDKPKI-së që shuma prej 1.000.000 lekësh, e përfituar nga z. E. K. si kundërshpërblim dhe e deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 me emërtimin “bono thesari BKT”, të korrigjohet me emërtimin “shtesë lekësh gjendje në banesë”, si një fakt që, sipas tij, provon se kjo shumë ka qenë gjendje *cash* në banesë, trupi gjykues konstaton si më poshtë.
141. Nga verifikimi i DIPP-së së vitit 2008, rezulton se në faqen e parë të këtij deklarimi, ekziston shënimi: *Bashkëngjitur deklaratë, datë 25.03.2009, faqe 2, BKT, nr. {***}, datë 24.03.2009, vërtetim bono thesari, datë 5.07.2007 (fotokopje), vërtetim bono thesari, datë 17.01.2008 (fotokopje)*. Megjithatë, referuar akteve të administruara nga Komisioni në fashikullin e ILDKPKI-së, nuk rezulton që DIPP-së së vitit 2008 t'i jetë bashkëlidhur ndonjë deklaratë sipas shënimit të mësipërm.
142. Po ashtu, kopja e deklaratës së pretenduar, e paraqitur nga subjekti me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, nuk përmban asnjë element që të provojë depozitimimin e saj pranë ILDKPKI-së, pasi nuk rezulton e protokolluar apo e marrë në dorëzim nga ky institucion. Për më tepër, informacioni dhe saktësimi i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kësaj deklarate, nuk gjejnë reflektim as në DIPP-në e vitit 2008, rrethanë që e bën të pamundur gjurmimin e këtij korrigjimi nga ana e institucioneve kontrolluese.
143. Trupi gjykues vëren gjithashtu se, referuar raportit të ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 01.02.2019, në analizën e kryer lidhur me depozitën bankare në Raiffeisen Bank, krijuar më datë 11.10.2016 në vlerën 1.450.000 lekë, ky institucion nuk referon deklaratën e pretenduar

²² Referuar jurisprudencës së Kolegjit në vendimet e juridiksionit të rivlerësimit: nr. 8/2019, nr. 11/2019, nr. 19/2019, nr. 29/2019, nr. 1/2020, nr. 20/2020 dhe nr. 26/2022.

nga subjekti i rivlerësimit si dokument të administruar, ndonëse në raport janë listuar rregullisht dokumentet e tjera të administruara (faqe 11 e raportit).

144. Po ashtu, nuk rezulton që ILDKPKI-ja të ketë pranuar apo konsideruar korrigjimin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, pasi, në përfundim të analizës së kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se shuma progresive e gjendjes *cash* deri në vitin 2010, referuar deklarimeve periodike ndër vite, rezulton të jetë rreth 500.000 lekë, ndërsa diferenca prej rreth 1.000.000 lekësh për krijimin e depozitës, nuk justifikohet me gjendjen *cash* të akumuluar ndër vite.
145. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se të ardhurat nga kundërshpërblimi janë deklaruar si pjesë e gjendjes *cash* nëpërmjet deklaratës së pretenduar si të bashkëlidhur DIPP-së së vitit 2008, nuk provohet nga aktet e administruara në fashikull dhe as rezulton të jetë marrë në konsideratë nga ILDKPKI-ja në mënyrën e pretenduar prej tij.
146. Referuar përmbajtjes së deklaratës së paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit, trupi gjykues vëren se në këtë deklaratë, subjekti është shprehur se: *Në deklarin e pasurisë më datë 23.03.2008, kam pasqyruar si shtesë, shumën 1.000.000 lekë të reja, në pikën "bono thesari", Banka Kombëtare Tregtare. Nga veprimet e më vonshme me BKT, për tërheqjen e bonove të thesarit, konstatoj se këtë shumë unë e kam derdhur në bankë në datën 17.01.2008 dhe jo në fund të vitit 2007, siç kisha krijuar idenë, kjo shumë në fund të vitit 2007 ka qenë gjendje në banesë dhe më 17.01.2008, unë e kam çuar në BKT për ta depozituar si "bono thesari". Me 25 mars të vitit 2009, në deklarin e pasurisë, këtë shumë e kam deklaruar si shtesë të ardhurash në vitin 2008, pasi realisht kjo shumë është derdhur për bono thesari më datë 17.01.2008 e jo në vitin 2007. Për këtë arsye, kërkoj që në deklaratën time të pasurisë të vitit 2007, të plotësuar më datë 23.03.2008, të bëhet ndryshimi: të hiqet si shtesë pasurie rubrika "Bono e thesarit, Banka Kombëtare Tregtare" për vlerën 1.000.000 lekë (Rubrika nr. 2). Kjo shumë të pasqyrohet si shtesë lekësh gjendje në banesë, ku nga shuma 200.000 lekë që kam deklaruar, të bëhet 1.200.000 lekë (rubrika 4). [...] Ky ndryshim provohet me prova shkresore, vërtetim nr. {***} prot., datë 24 mars 2009, të Bankës Kombëtare Tregtare ShA, dega Elbasan (shoqëruar me vërtetim provon faktin se në vitin 2007, kam depozituar për bono thesari 500.000 lekë të reja e jo 1.500.000 lekë (bono thesari) siç kam deklaruar në shtesën e të ardhurave për vitin 2007. Fotokopjen e vërtetimit të blerjes bono thesarin në shumën prej 1.000.000 lekësh, e kam derdhur në vitin 2008.*
147. Sa më sipër, në vlerësimin e trupit gjykues, në këtë deklaratë duket se subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shuma prej 1.000.000 lekësh e përfituar si kundërshpërblim nga shtetasi E. K. në vitin 2007, është mbartur *cash* deri në fund të këtij viti dhe se kjo shumë është derdhur si bono thesari më 17.01.2008. Nisur nga sqarimi i dhënë nga subjekti në deklaratën e pretenduar, edhe nëse do të merrej në konsideratë pretendimi i tij se kjo shumë ka qenë gjendje *cash* deri në fund të vitit 2007, e njëjta shumë në DIPP-2008 deklarohet e depozituar si bono thesari më 17.01.2008, dhe jo si likuiditet gjendje *cash* në banesë.
148. Po ashtu, trupi gjykues konstaton se, referuar DIPP-2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Depozitë kursimi në BKT, dega Elbasan, datë 04.09.2008, nga tërheqja e bonove të thesarit të vitit 2007 dhe 2008 në BKT, vlera 1.500.000 lekë. Pakësime: Tërheqja bono thesari nga BKT, datë 04.09.2008, vlera 500.000 lekë. Tërheqje bono thesari nga BKT, datë 04.09.2008, vlera 1.000.000 lekë, të cilat deklarohen si burim për depozitën e kursimit në BKT, dega*

Tiranë, krijuar më datë 04.09.2008, me vlerë 1.500.000 lekë. Për rrjedhojë, nga leximi harmonik i këtyre deklarimeve, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se shuma me vlerë 1.000.000 lekë është mbartur *cash* deri në vitin 2016, pakësuar më tej në favor të pasurisë depozitë në Raiffeisen Bank, është i pambështetur në prova.

149. Në përfundim të kësaj analize, bazuar në sa më sipër, si dhe në dritën e vlerës provuese që deklaratat periodike vjetore kanë sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon të drejtë vlerësimin e Komisionit se shuma prej 1.000.000 lekësh nuk rezulton të jetë deklaruar si shtim likuiditeti në gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar në vitin 2007 e në vijim.
150. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, lidhur me gjendjen në llogarinë rrjedhëse në Raiffeisen Bank, në vlerën 1.449.759 lekë, është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj në shumën 950.000 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Lidhur me të ardhurat e përfituara në bazë të vendimit nr. {***}, datë 25.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan:*

151. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim, konkluzionin e Komisionit se: *veprimet dhe qëndrimet e subjektit përkojnë me përpjekje për të gjeneruar dhe mundësuar vlerësime maksimale të përfitimit të tij, edhe përtej çka mund t'i takonte, në kapërcim të dukshëm të logjikës ekonomike dhe në mungesë të harmonisë së logjikshme midis provave të dëmeve/vlerave ekzistuese dhe dëmshpërblimeve apo çmimeve të përfituara, që çojnë në konkluzionin se ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe që, kështu, këto fakte duhet të mbahen në vëmendje, në aplikimin e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në gërshetim edhe me konstatimet e tjera.*
152. Në lidhje me këto të ardhura, Komisioni ka vlerësuar në vendim se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë plotësisht bindëse, pasi rezultojnë kontradiktore në raport me masën e dëmtimit të përcaktuar nga ekspertët dhe masën e përfitimit ekonomik të realizuar prej subjektit, duke krijuar përshtypjen e veprimeve të kryera në mënyrë favorizuese, me qëllim përfitimin e një dëmshpërblimi më të lartë se dëmi i shkaktuar.
153. Mbi këtë bazë, Komisioni ka arritur në përfundimin se ekziston mospërputhje e dukshme midis akteve të ekspertimit të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, sipas të cilave dëmtimi është cilësuar si “plagosje e lehtë”, dhe aktit të ekspertimit që ka përcaktuar se subjekti i rivlerësimit “përfiton paaftësi të përhershme në masën 20%, duke filluar nga data e aksidentit”. Sipas Komisionit, ndonëse nuk është konstatuar ndonjë konflikt interesi në raport me shoqërinë e sigurimit, në kuptimin që subjekti i rivlerësimit të ketë përfaqësuar organin e prokurorisë ndaj kësaj pale, mbetet dyshimi se ai ka përfitur, për shkak të funksionit, një dëmshpërblim më të lartë nga sa i takonte realisht.
154. Në vijim, Komisioni ka arsyetuar se, duke mbajtur në konsideratë edhe kundërshtimin e pretenduar prej 1.000.000 lekësh për një dëm të papësuar, si dhe diferencat e çmimeve të mjeteve motorike, të konsideruara pa logjikë ekonomike, krijohet bindja e brendshme se veprimet dhe qëndrimet e subjektit të rivlerësimit përkrijnë me përpjekje për të gjeneruar dhe mundësuar vlerësime maksimale të përfitimeve të tij, edhe përtej asaj çka mund t'i takonte,

rrethana të cilat çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, rrethana që duhet të mbahet në konsideratë në aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në gërshetim edhe me konstatimet e tjera të evidentuara gjatë rivlerësimit.

155. Në lidhje me arsyetimin dhe konkluzionin e Komisionit mbi këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se Komisioni ka dalë përtej parashikimeve të Kushtetutës, ligjit, si dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurave Administrative, kur ka arritur në përfundimin se shpjegimet e dhëna prej tij nuk janë plotësisht bindëse. Sipas subjektit të rivlerësimit, praktika e aksidentit është e plotë dhe aktet e administruara në këtë praktikë nuk mbështesin konkluzionin e arritur nga Komisioni.
156. Në analizë të sa më sipër dhe referuar akteve të administruara në fashikull, trupi gjykues konstaton si vijon.
157. Subjekti i rivlerësimit ka përfituar në vitin 2017 të ardhura në formën e dëmshpërblimit, në vlerën totale 3.099.174 lekë, nga shoqëria e sigurimeve “{***}” ShA, për shkak të dëmi pasuror dhe jopasuror. Këto të ardhura janë deklaruar në DIPP-të e viteve 2017 dhe 2018, përkatësisht në shumat 1.500.000 lekë dhe 1.599.174 lekë. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të subjektit, konfirmohen transfertat e kryera nga “{***}” ShA në favor të tij, konkretisht: (i) 1.500.000 lekë më datë 18.12.2017; (ii) 799.174 lekë më datë 16.02.2018; dhe (iii) 800.000 lekë më datë 16.04.2018.
158. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të sqarojë dinamikën e ngjarjes, si dhe të paraqesë dokumentacionin ligjor mbi bazën e të cilit është vendosur dhënia e dëmshpërblimit, përfshirë praktikën e plotë të dëmshpërblimit dhe vendimin/vendimet gjyqësore përkatëse, si dhe të bëjë me dije mbi ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesave për palët e përfshira. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nuk ka pësuar dëme materiale, pasi mjeti me të cilin udhëtonte, nuk ishte në pronësinë e tij dhe ai nuk ishte drejtues i mjetit, por pasagjer. Subjekti ka deklaruar se, si pasojë e aksidentit, ka pësuar dëmtime shëndetësore, konkretisht thyerje totale të krahut të djathtë dhe dëmtime në shpatull, ndërsa familjarët e tij kanë përfituar dëmshpërblim për dëmin moral dhe ekzistencial. Po ashtu, ai ka deklaruar se nuk ka pasur konflikt interesi me shtetasen N. M., shoqërinë “{***}” ShA apo ortakët e saj, si dhe se, për shkak të zgjidhjes së çështjes me marrëveshje mirëkuptimi, nuk është kryer raport ekspertimi nga ekspertë mjeko-ligjorë për t’u paraqitur në gjykatën civile.
159. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.07.2021, i është drejtuar shoqërisë “{***}” ShA për informacion dhe dokumentacion lidhur me dëmshpërblimin në vlerën 3.099.174 lekë të përfituar nga subjekti i rivlerësimit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, shoqëria “{***}” ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.08.2021, ka paraqitur marrëveshjen për zgjidhjen me mirëkuptim, policat e sigurimit të dy automjeteve të përfshira në aksident, aktin e ekspertimit autoteknik të datës 15.05.2017, vlerësimin mjeko-ligjor dhe aktvlerësimin financiar. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se subjekti i

rivlerësimit ka përfituar paaftësi të përhershme në masën 20%²³, duke filluar nga data e aksidentit.

160. Me vendimin nr. {***} ({***}-2017-***), datë 25.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është vendosur lëshimi i urdhrit të ekzekutimit për miratimin e zgjidhjes me pajtim të mosmarrëveshjes dhe detyrimin e shoqërisë “{***}” ShA t’i paguajë subjektit të rivlerësimit shumën prej 3.099.174 lekësh, si dëm jopasuror i pësuar nga aksidenti i datës 15.05.2017.
161. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të sipërcituara, trupi gjykues çmon se analiza e Komisionit, lidhur me raportin ndërmjet masës së dëmtimit të vlerësuar nga ekspertët dhe masës së përfitimit ekonomik të realizuar nga subjekti i rivlerësimit, mbështetet në një konstatim të gabuar të situatës faktike.
162. Referuar vendimit nr. {***} ({***}-2017-***), datë 25.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me anë të të cilit është vendosur: “Lëshimi i urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. {***} ({***}-2017-***), datë 25.10.2017, për miratimin e zgjidhjes me pajtim të mosmarrëveshjes dhe detyrimin e të paditurit “{***}” ShA t’i paguajë paditësit Binas Nina dëmin jopasuror të pësuar si pasojë e aksidentit të datës 15.05.2017, në shumën 3.099.174 lekë”, rezulton e provuar se këto të ardhura janë përfituar në formën e dëmshpërblimit, mbi bazën e marrëveshjes për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjes me shoqërinë “{***}” ShA, për dëmin jopasuror të pësuar nga subjekti i rivlerësimit në aksidentin e ndodhur më datë 15.05.2017.
163. Në këtë marrëveshje, provohet jo vetëm ndodhja e aksidentit, por edhe fakti se shuma e dëmshpërblimit prej 3.099.174 lekësh është përcaktuar mbi bazën e vendimit nr. {***} prot., datë 06.09.2017, të grupit të ekspertëve sigurues të Byrosë Shqiptare të Siguruesve, i cili, në përputhje me dosjen klinike të pacientit Binas Nina dhe referuar parashikimeve ligjore të zbatueshme për trajtimin e dëmeve që mbuloohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në transport, ka vlerësuar masën e paaftësisë së përhershme në nivelin 20% për subjektin e rivlerësimit.
164. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se masa e dëmtimit rezulton të jetë përcaktuar nga grupi i ekspertëve sigurues, si një fakt i provuar përpara Komisionit nëpërmjet akteve shkresore të paraqitura si nga vetë subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe nga shoqëria e sigurimit që ka kryer pagesën e dëmshpërblimit. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se përfundimi i Komisionit lidhur me mosbindshmërinë e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi masën e dëmtimit, rezulton i pambështetur.
165. Përveç sa më sipër, në lidhje me dëmshpërblimin objekt shqyrtimi, nuk rezulton që nga ana e Komisionit të jenë konstatuar elemente të konfliktit të interesit ndërmjet shoqërisë së sigurimit dhe subjektit të rivlerësimit, apo të jenë ngritur dyshime konkrete se subjekti ka përfituar në mënyrë favorizuese.
166. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se kjo e ardhur është përfituar nga subjekti i rivlerësimit pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, si dhe rrethanën që Komisioni

²³ Sipas vendimit të grupit të ekspertëve sigurues nr. {***} prot., datë 06.09.2017.

nuk ka arsyetuar mbi nevojën e verifikimit të të ardhurave që kronologjikisht i përkasin vitit 2017.

167. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se analiza e kryer nga Komisioni lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe konkluzioni për cenim të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, rezultojnë të pambështetura në fakte dhe në ligj.

➤ *Lidhur me analizën financiare 2003 – 2016:*

168. Në kundërshtim të rezultatit të analizës financiare për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se: (i) Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e përfituara gjatë viteve 2001 dhe 2002 nga dërgesat e kryera nga shtetasit B. S., në shumat 422,82 GBP dhe 424,74 GBP, I. B. në shumën 346,64 GBP, si dhe A. B. në shumën 369,89 USD. Sipas subjektit, në analizën financiare nuk është përfshirë në total shuma prej 301.174 lekësh; (ii) Komisioni nuk ka përfshirë në kategorinë e të ardhurave të ligjshme, shumën prej 300.000 lekësh të përfituar nga shitja e automjetit me targë {***}; (iii) Komisioni, për të gjitha vitet objekt analize, ka përllogaritur shpenzime jetese më të larta nga sa kanë qenë realisht për familjen e tij, pasi nuk është marrë në konsideratë fakti se familja ka jetuar gjatë gjithë kohës në qytetin e Elbasanit, ku, referuar të dhënave të INSTAT-it, niveli i shpenzimeve të jetesës është më i ulët krahasuar me kryeqytetin. Po ashtu, sipas subjektit, konkluzioni i Komisionit se ai nuk ka deklaruar që në vitin 2004, ka jetuar te vjehri, është në kundërshtim me deklaratimet e bëra prej tij pranë ILDKPKI-së²⁴; (iv) për shpenzimet e udhëtimit në Maqedoninë e Veriut janë përllogaritur në mënyrë të padrejtë, shpenzime në një nivel shumë më të lartë nga ai real, të cilat, sipas subjektit, arrijnë pothuajse në vlerën e shpenzimeve të jetesës së familjes për një periudhë njëvjeçare.

169. Në analizë të këtyre pretendimeve dhe nga verifikimi i akteve të administruara në fashikull, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, ka deklaruar: “Dërgesa nga shtetasit Y. B., A. B. dhe A. S., përkatësisht vëllezërit dhe kushëriri i bashkëshortes, në shumat përkatëse 346 euro, 396 euro dhe 846 USD”.

170. Për këta shtetas, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratatë noteriale, të cilat konfirmojnë dërgimin e shumave përkatëse, por nuk ka mundur të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të provuar burimin e ligjshëm të tyre, me argumentin se, për shkak të largimit të këtyre shtetasve nga Mbretëria e Bashkuar, ata ndodhen në pamundësi për të siguruar dokumentacionin provues.

171. Megjithatë subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nga ana e tij nuk është paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë përpjekjet e kryera prej tij apo personave të lidhur për sigurimin e dokumentacionit përkatës. Për më tepër, referuar deklaratave noteriale²⁵ të depozituara nga subjekti në kuadër të pyetësorëve, rezulton

²⁴ Sipas subjektit, gjatë intervistimit në vitin 2016, në pikën 22 të këtyre shpjegimeve pranë ILDKPKI-së, ka deklaruar se në vitin 2004, fëmijët jetonin në shtëpinë e prindërve të bashkëshortes së tij, tek l. dhe Xh. B., konkretisht: "sqaroj se në vitin 2004, unë kam banuar te vjehri im I. B., për shkak se vjehrra ime kujdesej për fëmijët e mi të mitur, pra shpenzimet e konsumit familjar në masën më të madhe përballoheshin nga vjehri".

²⁵ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.08.2021, nga z. A. S., deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.08.2021 nga z. Y. B., deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.08.2021, nga z. A. B..

se të tre dërguesit kanë deklaruar se nuk kanë qenë të pajisur me leje qëndrimi, shtetësi apo vizë, duke lënë të kuptohet se kanë jetuar dhe punuar në mënyrë të parregullt në Mbretërinë e Bashkuar.

172. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se qëndrimi i Komisionit lidhur me moskonsiderimin e këtyre të ardhurave si burime të ligjshme financiare, është në përputhje me nenin 34, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit.
173. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare shumën prej 300.000 lekësh, të përfituar nga shitja e automjetit me targë {***}, trupi gjykues verifikoi analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2013, vit në të cilin automjeti është shitur nga subjekti.
174. Nga ky verifikim, rezultoi se, në rubrikën “Të ardhura të subjektit të vërtetuara”²⁶, është përfshirë shuma totale prej 1.478.234 lekësh, ndonëse në këtë rubrikë nuk paraqiten në mënyrë të detajuar zërat përbërës të të ardhurave. Megjithatë, nga verifikimi i akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, rezultoi se analiza financiare e kryer nga prej tij, e paraqitur në format *excel*, përmban të detajuar zërat e të ardhurave të përfshira në këtë shumë totale, konkretisht: “Të ardhura nga paga e subjektit” në vlerën 1.147.412 lekë, “Të ardhura nga interesat bankarë” në vlerën 30.822 lekë dhe “Të ardhura nga shitja e automjetit” në vlerën 300.000 lekë (1.147.412 lekë + 30.822 lekë + 300.000 lekë = 1.478.234 lekë).
175. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni i ka përlloritur saktë të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit, për rrjedhojë ky pretendim i subjektit të rivlerësimit rezultoi i pabazuar.
176. Në lidhje me pretendimet e subjektit për shpenzimet e jetesës, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, ka kërkuar që për vitin 2004 dhe vitin 2005, të zbriten shpenzimet e jetesës së fëmijëve, pasi, duke qenë të vegjël, kanë jetuar me vjehrrit. Komisioni në vendim, në analizën financiare të periudhës 2003-2016, ka arsyetuar se: *Sa i përket pretendimit për uljen e shpenzimeve të jetesës së fëmijëve, ky pretendim nuk është pranuar nga trupi gjykues, për sa kohë nuk është deklaruar apo pretenduar prej subjektit në ndonjë moment përgjatë procesit të rivlerësimit.*
177. Nisur nga pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim, se Komisioni ka arritur në konkluzione në kundërshtim me deklaratimet e tij pranë ILDKPKI-së, trupi gjykues, referuar procesverbalit të datës 04.04.2016, të mbajtur pranë ILDKPKI-së ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe ndihmësinspektorit F. T., vëren se, në përgjigje të pyetjes nr. 22, subjekti ka deklaruar se: “Në vitin 2004, unë kam banuar te vjehri im I. B. për shkak se vjehrra ime kujdesej për fëmijët e mi të mitur, pra shpenzimet e konsumit familjar në masën më të madhe përballoheshin nga vjehri”.
178. Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që, për vitet 2004 dhe 2005, të zbriten shpenzimet e jetesës së fëmijëve, me argumentin se, për shkak të moshës së vogël, ata kanë jetuar te vjehrrit. Po ashtu, në ankim, subjekti ka sqaruar se gjatë vitit 2004,

²⁶ Faqe nr. 40 e vendimit të Komisionit, tabela emërtuar “Aneksi nr. 1 – Analiza financiare për periudhën 2003-2016”.

ka banuar te vjehri dhe se *shpenzimet e konsumit familjar, në pjesën më të madhe, janë përballuar prej tij.*

179. Lidhur me sa më sipër, referuar deklaramëve dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me pretendimin për uljen e shpenzimeve të jetesës gjatë viteve 2004 dhe 2005, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka qenë i qartë sa i takon faktit nëse te vjehri kanë banuar e gjithë familja apo vetëm fëmijët dhe, nëse po, për cilën periudhë konkrete bëhet fjalë, pasi fillimisht ai i referohet vetëm vitit 2004, ndërsa më pas përfshin edhe vitin 2005.
180. Për më tepër, ky pretendim rezulton në kundërshtim me përgjigjet e dhëna prej subjektit të rivlerësimit në pyetësin nr. 1²⁷, lidhur me adresat e vendbanimit ndër vite. Në këto kushte, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhe as ka shpjeguar në mënyrë të qartë dhe bindëse rrethanën e pretenduar prej tij, trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit lidhur me mospranimin e pretendimeve për uljen e shpenzimeve të jetesës së fëmijëve. Për rrjedhojë, zëri i shpenzimeve të jetesës për vitet 2004 dhe 2005, në analizën financiare mbetet i pandryshuar.
181. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për uljen e shpenzimeve të jetesës sipas rajonit, me argumentin se familja e tij ka jetuar gjatë gjithë kohës në qytetin e Elbasanit dhe, për rrjedhojë, ka pasur shpenzime jetese më të ulëta, trupi gjykues konstaton se ky pretendim ngrihet për herë të parë në ankim, pasi nuk rezulton të jetë parashtruar gjatë procesit të zhvilluar pranë Komisionit.
182. Trupi gjykues konstaton se shpenzimet e jetesës për subjektin e rivlerësimit dhe familjen e tij janë përlllogaritur nga Komisioni sipas të dhënave zyrtare të INSTAT-it dhe standardit të zbatuar nga ILDKPKI-ja, ku përfshihen të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat e Shqipërisë. Për rrjedhojë, këto të dhëna nuk mund të pasqyrojnë shpenzimet reale të çdo individi apo familjeje në çdo qytet të vendit. Në këtë kuptim, ato përbëjnë një vlerë mesatare, e cila përfaqëson standardin e një jetese normale për një njësi familjare dhe jo domosdoshmërisht shpenzimet konkrete të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit vlerësohet i pambështetur.
183. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit sa u takon shpenzimeve të udhëtimeve familjare të kryera me destinacion Maqedoninë e Veriut, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se, për sa i përket pretendimit të subjektit, të parashtruar edhe gjatë seancës dëgjimore, lidhur me uljen e këtyre shpenzimeve, në mungesë të provës së kundërt mbi shpenzimet reale të kryera gjatë këtyre udhëtimeve, duhet t'i qëndrohet metodologjisë së përdorur nga Kolegji në vendimin nr. 11/2019 (JR).
184. Ky vendim ka orientuar praktikën gjyqësore lidhur me përcaktimin e këtij zëri shpenzimesh në analizën financiare të kryer për subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta gjatë

²⁷ Në këtë pyetësor, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “Qëkur kam filluar detyrën e Prokurorit më datë 10.09.1995, kam banuar në këto adresa: 1. Apartamenti {***}, shkalla {***}, kati {***}, pallati {***}, qyteti Elbasan. Kam qenë pronar i këtij apartamenti, në fillimin të marrjes së detyrës. 2. Pallati i ri, pranë Pallatit {***} Elbasan, rruga “{***}”, lagjja “{***}”, Elbasan. Kam qenë fillimisht që në vitin 2001, posedues i këtij apartamenti sipas kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, e përfaqësuar nga A. V. G. dhe në vitin 2013 jam bërë pronar”.

periudhës së rivlerësimit. Për sa më sipër, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit vlerësohet i pabazuar.

185. Në përfundim të sa më sipër, nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003–2016, si dhe pas marrjes në konsideratë të disa prej pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konkretisht lidhur me përfshirjen në analizën e vitit 2007 të shumës prej 1.000.000 lekësh, si dhe gjendjes *cash* të kursyer në banesë në datën 01.01.2006, të analizuar më sipër në këtë vendim, rezulton se subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë negative: për vitin 2004, në shumën (-) 393.543 lekë; për vitin 2006, në shumën (-) 116.720 lekë; për vitin 2008, në shumën (-) 156.257 lekë; për vitin 2009, në shumën (-) 107.911 lekë; për vitin 2010, në shumën (-) 416.103 lekë; për vitin 2014, në shumën (-) 453.377 lekë; për vitin 2015, në shumën (-) 64.628 lekë; dhe për vitin 2016, në shumën (-) 1.020.617 lekë.
186. Për rrjedhojë, balanca negative e përllogaritur nga Komisioni ulet nga shuma (-) 3.440.634 lekë në shumën (-) 2.729.155 lekë.
187. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se, lidhur me analizën financiare për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
188. Në përfundim të analizës lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues vlerësoi se konstatimet e Komisionit në lidhje me automjetin “Mercedes Benz”, me targë {***}, pasuritë “tokë arë”, si dhe huadhënien në shumën 3.500.000 lekë, janë pa peshë dhe të panevojshme për t’u analizuar më tej në drejtim të vlerësimit të këtij kriteri, për sa kohë Komisioni nuk i ka kualifikuar problematikat e evidentuara në lidhje me këto pasuri sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si shkak për aplikimin e nenit 61, pika 3 e të njëjtit ligj dhe, për rrjedhojë, trajtimi i mëtejshëm i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këto pasuri, nuk ka ndikim në vendimmarrjen e Kolegjit.

Ç. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe cenimin e besimit

189. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit²⁸ se: *disa nga problematikat e konstatuara në kriteret e vlerësimit, të cilat, ndonëse nuk mjaftonin në vetvete për aplikimin e ndonjë mase specifike lidhur me kriterin me të cilin janë evidentuar, parë në tërësinë e tyre, krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, rrjedhimisht, duhet të aplikohet edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
190. Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti ka arritur nivel kualifikues, sipas nenit 59, paragrafi 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
191. Në arritjen e këtij konkluzioni, Komisioni është mbështetur në analizën e disa veprimeve apo mosveprimeve të subjektit, si: transaksione të konsideruara jashtë logjikës ekonomike, lidhur me kundërshtëpërbimin e pretenduar për një dëm të papësuar në shumën 1.000.000 lekë,

²⁸ Në paragrafin nr. 309/d të vendimit të Komisionit.

përfitimim e dëmshpërblimit nga një aksident automobilistik më shumë se sa ishte dëmtuar realisht, si dhe diferencat e çmimit të automjeteve pa logjikë ekonomike.

192. Po ashtu, rezulton se në këtë konkluzion duket se kanë ndikuar edhe indiciet nga informacionet e klasifikuara që lidhen me dosjet nr. 1 dhe nr. 2, dinamikën dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve përkatëse, si dhe qëndrimet, veprimet hetimore dhe konkluzionet e subjektit të rivlerësimit në dosjet profesionale të shqyrtuara nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale.
193. Në kundërshtim të këtij konkluzioni, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përgjithshme pretendoi në ankim, se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë faktin se dosjet penale të shqyrtuara për vlerësimin e punës së tij hetimore, janë kontrolluar nga gjykatat kompetente dhe se vendimet e dhëna prej tyre, janë në fuqi. Sipas subjektit, vendimmarrja e Komisionit cenon parimin e gjësë së gjykuar dhe atë të sigurisë juridike, si dhe del jashtë kompetencave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016.
194. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë faktin se pozita procedurale e shtetasit D. K. (referuar në paragrafin 268 të vendimit të Komisionit) është vlerësuar nga gjykata kompetente sipas vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë dhe, sipas tij, Komisioni del si mbi gjykatën që e ka gjykuar çështjen, ashtu edhe mbi qëndrimin e Gjykatës së Lartë, duke mbajtur qëndrim mbi mënyrën se si do të duhej të vepronte/arsyetonte prokurori në trajtimin e kësaj çështjeje, qëndrim i cili del jashtë diskrecionit të Komisionit.
195. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka konstatuar favorizime, ndërsa nga ana tjetër, në përfundim, pa asnjë fakt apo indicie konkrete, arrin në konkluzionin se ai ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe gjen të zbatueshëm nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti pretendoi se kjo mënyrë vlerësimi bie në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor, për sa kohë vendimmarrja është mbështetur në prova që nuk i janë nënshtruar shqyrtimit në seancë dëgjimore dhe është e paarsyetuar.
196. Lidhur me pretendimin e subjektit sa i takon procedimit penal nr. {***/2014, që lidhet me shtetasin D. K., trupi gjykues vëren se Komisioni ka analizuar dhe ia ka nënshtruar vlerësimit të tij, veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të këtij procedimi penal, duke konstatuar se praktikat e ndjekura nga subjekti dhe argumentimi që ai ka bërë lidhur me pozitën procedurale të shtetasit D. K., nuk është i saktë, pasi, referuar rrethanave të ngjarjes, vlerësohet që shtetasi D. K. është bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale “Dhunë në familje” dhe duhet të ishte akuzuar edhe ai për këtë vepër penale.
197. Referuar këtij konkluzioni, si dhe pretendimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit në ankim, nga analiza e akteve të administruara nga Komisioni, rezulton se procedimi penal nr. {***/2014 është regjistruar në datën 05.08.2014, me të pandehur N. K., akuzuar për veprën penale të “Dhunës në familje”, kryer dy herë, parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal. Ndërkohë që, sipas informacionit për referimin e veprës penale te prokurori, rezulton që në ngjarjen e datës 02.07.2014, përveç shtetasit N. K., është përfshirë edhe i biri, shtetasi D. K., i cili, po ashtu, referohet se ka goditur bashkëshortin e kallëzueses L. B..
198. Trupi gjykues vëren se shtetasi D. K. fillimisht është trajtuar nga subjekti i rivlerësimit, si person nën hetim për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, ndërkohë që

në aktin për dërgimin e çështjes në gjyq, datë 11.12.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të dërgojë çështjen për gjykim vetëm në ngarkim të shtetasit N. K., ndërsa në lidhje me shtetasin D. K., në dokumentin “Diskutime përfundimtare”, është shprehur se: [...] D. K., i cili ka goditur me shkelm shtetasin P. B., vepra penale e konsumuar parashikohet si rrahje, neni 90/2 i Kodit Penal. Për këto vepra penale, në bazë të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, ankuesi ka të drejtën e ankimit në gjykatë në cilësinë e të dëmtuarit akuzues.

199. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit lidhur me secilën prej çështjeve të marra në analizë si bazë për vlerësimin se subjekti ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se konstatimet e Komisionit kanë një peshë të atillë që nuk mund të ngrihen në nivelin e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
200. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në konkluzionet e arsyetuara më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke u gjendur në kushtet e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
201. Për rrjedhojë, vendimi nr. 489, datë 16.12.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit vlerësohet i mbështetur në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 489, datë 16.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Binas Nina.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 06.03.2025.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi